



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Raporti Statistikor Mujor i Ministrisë së Punëve të Brendshme

Shkurt 2026

Raporti Statistikor Mujor i Ministrisë së Punëve të Brendshme

Ky raport u përgatit nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe pasqyron treguesit kryesor zyrtar të fushave kryesore që mbulon Ministria e Punëve të Brendshme dhe në nivel më të detajuar të veprave penale të Republikës së Shqipërisë

Shkurt 2026

© Të drejtat e autorit: Ministria e Punëve të Brendshme

Ndalohet riprodhimi i këtij botimi apo transmetimi i tij në cilëndo formë, pa autorizimin paraprak me shkrim të mbajtësit të së drejtës së autorit.

Ministria e Punëve të Brendshme
Sheshi Skënderbej,
Nr.3, Tiranë, 1000, Shqipëri

Përmbajtja:

- **Vepra Penale dhe Autorë për Vepra Penale**
- **Vepra Penale Kundër Personit**
- **Vepra Penale Kundër Pasurisë**
- **Vepra Penale për Krim Ekonomik dhe Financiar**
- **Vepra Penale të Trafiqeve të Paligjshme**
- **Vepra Penale në Fushën e Drogave**
- **Vepra Penale për Krim Kompjuterik**
- **Vepra Penale për Krim Mjedisor**
- **Vepra Penale mbi Qarkullimin Rrugor**
- **Tregues mbi Bashkëpunimin Ndërkombëtar**
- **Vepra Penale mbi Menaxhimin e Kufijve**
- **Vepra Penale - Krahasime sipas Qarqeve**
- **Integriteti dhe Besimi në Polici**
- **Tregues për Gjendjen Civile**
- **Tregues të Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit**
- **Tregues mbi Azilin dhe Shtetësinë**
- **Tregues mbi Marrëveshjet**
- **Tregues mbi Qendrën Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit**
- **Tregues për Mbrojtjen nga Zjarri**

Kategoritë e neneve të përfshira

A. KUNDËR PERSONIT

Vrasjet (N.76, 78-79, 79/a/b/c)
Plagosjet e rënda (N. 88+88/a.88/b.91.)
Armëmbajtje pa leje (N. 278/278/279/280)
Braktisja e fëmijëve të mitur (N. 124)
Keqtrajtimi i të miturit (N. 124/b)
Krime seksuale (N.100-104, n.107/a)

B. KUNDËR PASURISË

Gjobëvënie (N.109/b);
Vjedhje (N.139-140);
Vjedhje e mjeteve motorike
Vjedhje e bankave dhe arkave të kursimit (N.136)
Vjedhje me dhunë (N.139)
Vjedhje me armë (N.140)
Vjedhje me pasojë vdekjen (N.141)
Shkatërrimi i pronës me eksploziv (N. 152)

C. KRIME EKONOMIKE-FINANCIARE

Kontrabanda e mallrave (N.171-175, N.177)
Pastrimi i parave (N.287) - Sekuestrime
Antimafia: Asete kriminale - Sekuestrime
Antimafia: Asete kriminale – Konfiskime

Ç. TRAFIQET E PALIGJSHME

Trafikimi i të rriturve (N.110/a)
Shfrytëzim prostitucioni (N.114)
Trafikimi i të miturve (N.128/b)
Trafikimi i mjeteve motorike (N.141/a)
Trafikimi i armëve dhe i municionit (N.278/a)

D. NË FUSHËN E DROGAVE

Prodhim dhe shitje e narkotikëve (N.283)
Trafikimi i narkotikëve (N.283/a)
Kultivimi i bimëve narkotikëve (N.284)
Prodhim i lëndëve e narkotikëve (N.284/c)
Prodhim i prekursorëve (N.284/ç)
Struktura kriminale në fushën e narkotikëve (N.284/a)

E. KRIMI KOMPJUTERIK (N.143/b, 192/b, 293/a/b/c/ç)

Vepra penale në fushën e Teknologjisë së Informacionit
Vepra penale të kryera nëpërmjet sistemit kompjuterik

F. KRIMI MJEDISOR

Ndërtim i paligjshëm (N.199/a/b)
Prerja e paligjshme e pyjeve (N. 205)

G. NË FUSHËN E QARKULLIMIT RRUGOR

Shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor (N.290)
Drejtim i automjeteve në mënyrë të parregullt (N.291)
Largim nga vendi i aksidentit (N.273)
Aksidentet
Aksidente me pasojë vdekjen
Aksidente me pasojë plagosjen
Të vrarë në aksidente
Të plagosur rëndë në aksidente
Masat administrative nga Policia Rrugore (gjobat)

H. PERSONA TË KAPUR, NË KËRKIM BRENDA VENDIT E NDËRKOMBËTAR

Në kërkim kombëtar
Në kërkim ndërkombëtar

I. MENAXHIMI I KUFIJVE

Hyrje qytetarë të huaj
Turistë të huaj
Emigrantë të huaj të parregullt të kapur në vend
Azilkërkues shqiptarë në BE
Kthimet (vullnetare+azilkërkues të refuzuar, forcërisht)

F

Përmbledhje

Ky raport pasqyron në mënyrë të përmbledhur statistikat kryesore të Ministrisë së Punëve të Brendshme për muajin Shkurt 2026 me një fokus të veçantë në trendet e veprave penale.

Të dhënat që janë përdorur për përpilimin e kësaj analize përshkruese janë të mbështetura në të dhënat zyrtare të Ministrisë së Punëve të Brendshme, të mbledhura rast pas rasti nga Drejtoritë Rajonale të Policisë dhe përpunuar në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë për periudhën Shkurt 2026, si dhe nga drejtoritë përkatëse nën varësi të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Treguesit e trajtuar në këtë raport janë grupuar sipas fushave dhe neneve përkatëse të veprave penale sipas legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë. Të dhënat statistikore kanë filluar të mblidhen dhe përditësohen në kohë reale, në mënyrë elektronike në sistem të posaçëm nga viti 2015, dhe për këtë arsye analizat krahasimore kanë filluar nga ky vit.

Raporti Statistikor u është referuar të dhënave me bazë mujore dhe nivel kombëtar për të dhënë një pasqyrë në nivel makro të veprimtarisë së Ministrisë së Punëve të Brendshme në Republikën e Shqipërisë. Analiza është e mbështetur në të dhëna sasiore duke synuar që të jap një pamje sa më të plotë dhe transparente të punës së bërë nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Raporti prek disa nga fushat më kryesore të veprave penale, si ato ndaj personit, pasurisë, në fushën e drogave, trafiqeve të paligjshme, krimin mjedisor, krimin ekonomik, veprave penale në qarkullimin rrugor, etj.

Qëllimi kryesor i këtij raporti është që t'u vijë në ndihmë studiuesve dhe politikbërësve me një informacion sa më të kuptueshëm dhe të plotë mbi veprimtarinë e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe gjithashtu të koordinuar në nivel kombëtar. Raporti mundëson një pasqyrë të treguesve kryesorë, të cilave mund t'i referohen si të dhënat zyrtare të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Raporti Statistikor përveç trajtimit përshkrues të të dhënave përfshin edhe analiza krahasuese mes treguesve të ndryshëm për të pasqyruar më mirë shkaqet e ndryshimeve të trendeve të treguesve të caktuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Analiza e Veprave Penale dhe Autorëve të Veprave Penale Shkurt 2026

Analiza e veprave penale dhe autorë veprash penale

Kodi	Kategoria	Muaji					
		Shkurt 2022	Shkurt 2023	Shkurt 2024	Shkurt 2025	Janar 2026	Shkurt 2026
T1	Vepra penale të ndodhura	2,752	2,558	2,791	2,864	2,928	2,829
T2	Autorë veprash penale	2,716	2,517	2,727	2,925	2,940	3,556
T1_1	Vepra penale të ndodhura për 100 mijë banorë	60	56	61	62	59	61
T2_1	Autorë për vepra penale	0.99	0.98	0.98	1.02	1.05	1.26

Gjetjet Kryesore



Veprat penale gjatë muajit shkurt 2026 kanë shënuar 2,829 vepra dhe vihet re rënie me 35 vepra ose 2.1% më pak, krahasuar me muajin shkurt 2025 gjatë të cilit janë shënuar 2,864 vepra penale, gjithashtu krahasuar me muajin janar 2026, ka rënie me 99 vepra ose 3.4% ose vepra penale më pak.



Numri i autorëve të veprave penale gjatë muajit shkurt 2026 ka shënuar 3,556 autorë dhe krahasuar me muajin shkurt 2025 ka rritje me 631 autorë ose 21.6% më shumë, gjithashtu krahasuar me muajin janar 2026 ka rritje me 616 autorë ose 21% më shumë.



Veprat penale për 100 mijë banorë për muajin shkurt të vitit 2026 janë shënuar 61 vepra penale dhe krahasuar me të njëjtin muaj të një viti më parë ka rënie me 1 vepër më pak, ndërsa krahasuar me muajin janar 2026 ka rritje me 2 vepra penale më shumë.



Numri i autorëve për vepra penale për 100 mijë banorë, në muajin shkurt 2026 janë shënuar 0.24 autorë veprash penale më shumë, krahasuar me muajin janar 2025, gjithashtu krahasuar me muajin janar 2026, ka rritje me 0.21 autorë veprash penale më shumë.




Analiza e veprave penale dhe Autorë të Veprave Penale

Analiza Shpjeguese

Vepra Penale dhe autorë për vepra penale

Veprat penale gjatë analizës së muajit shkurt për periudhën pesëvjeçare 2022-2026, kanë shënuar numrin më të lartë në shkurt të vitit 2025 me 2,864 vepra penale të evidentuara, ndërsa numri më i ulët është shënuar në shkurt 2023 me 2,558 vepra penale të evidentuara. Në raport me mesataren e muajve shkurt 2022-2026 e cila shënon 2,759 vepra penale, gjatë muajit shkurt 2026 janë shënuar 70 vepra penale më pak. Muaji shkurt i vitit 2026 në krahasim me muajin shkurt 2025, ka shënuar rënie me 35 raste ose 1.2% më pak të veprave penale.

Autorët e veprave penale kanë arritur nivelin më të lartë në muajin shkurt 2026 me 3,556 autorë, ndërsa niveli më i ulët është shënuar në muajin shkurt 2023 me 2,517 autorë. Krahasuar me muajin shkurt 2025 gjatë të cilit janë shënuar 2,925 autorë, në muajin shkurt 2026 ka rritje me 21.6% ose 631 autorë më shumë. Numri i veprave penale për 100 mijë banorë ka shënuar nivelin më të lartë në muajin shkurt 2025 me 62 të tilla, ndërsa niveli më i ulët për periudhën e marrë në shqyrtim është shënuar në muajin shkurt të vitit 2023 me 56 vepra për 100 mijë banorë. Numri i autorëve për 100 mijë banorë ka shënuar nivelin më të lartë në muajin shkurt 2026 me vlerë 1.26 ndërsa niveli më i ulët për periudhën e marrë në shqyrtim është shënuar në muajin shkurt të vitit 2023 dhe 2024 me 0.98 autorë për 100 mijë banorë.





Analiza e veprave penale

Analiza Shpjeguese

Vepra Penale

Në muajin shkurt 2026 janë shënuar 2,829 vepra penale dhe krahasuar me muajin janar 2026 ku janë shënuar 2,928 vepra penale, ka rënie me 3.4% më pak.

Përgjatë periudhës janar-shkurt 2025, rezulton se ka pasur 5,631 dhe në raport krahasimor me periudhën janar-shkurt 2026, ku janë shënuar 5,466 vepra, ka rënie të veprave penale me 3% më pak.





Analiza e autorëve të veprave penale

Analiza Shpjeguese

Autorë për Vepra Penale

Numri i autorëve të veprave penale gjatë muajit shkurt 2026 janë shënuar 3,556 me 616 autorë ose 21% më shumë autorë se në muajin janar 2026, gjatë të cilit janë shënuar 2,940 autorë të implikuar. Numri i autorëve të veprave penale përgjatë periudhës janar-shkurt 2025, ka shënuar 5,801 vepra penale dhe krahasuar me të njëjtin muaj të një viti më parë, ku janë shënuar 6,277 vepra, ka rritje me 8% më shumë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Analiza Mujore e Veprave Penale Kundër Personit

Shkurt 2026

Përmbledhje e neneve të veprave penale kundër Personit

1. Vrasja me dashje (N76) - Vrasja e kryer me dashje dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.

Vrasja me paramendim (N 78) - Vrasja me paramendim dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë deri në njëzet e pesë vjet. Vrasja e kryer për interes apo hakmarrje dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm.

Vrasja për gjakmarrje (N 78/a) - Vrasja me dashje për gjakmarrje dënohet me burgim jo më pak se tridhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.

Vrasja në rrethana të tjera cilësuese (N79) - Vrasja me dashje e kryer: a) ndaj të miturit; b) ndaj personit me mangësi fizike ose psikike, të sëmurë rëndë ose shtatzënë, kur cilësitë e viktimës janë të dukshme ose të njohura; c) shfuqizuar; ç) ndaj kallëzuesit, dëshmitarit, të dëmtuarit ose palëve të tjera ndërgjyqëse; d) më shumë se një herë; dh) kundër dy ose më shumë personave; e) në mënyrë të tillë që i shkakton mundime të veçanta viktimës; ë) në mënyrë të rrezikshme për jetën e shumë personave, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm.

Vrasja e funksionarëve publikë (N 79/a) - Vrasja me dashje e deputetit, gjyqtarit, prokurorit, avokatit, ushtarakut apo e funksionarëve të tjerë publikë, gjatë detyrës ose për shkak të saj, kur cilësitë e viktimës janë të dukshme ose të njohura, dënohet me burgim jo më pak se tridhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm.

Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit (N 79/b) - Vrasja me dashje e punonjësve të Policisë së Shtetit, gjatë detyrës ose për shkak të saj, kur cilësitë e viktimës janë të dukshme ose të njohura, dënohet me burgim jo më pak se tridhjetë vjet ose me burgim të përjetshëm. Vrasja për shkak të arrëdhënieve familjare (N79/c) - Vrasja me dashje e personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo bashkëjetuese, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm.

2. Plagosja e rëndë me dashje (N 88) - Plagosja e kryer me dashje që ka sjellë si pasojë gjymtimin, shëmtimin ose çdo dëmtim tjetër të përhershëm të shëndetit, ndërprerjen e shtatzanisë, ose ka qenë e rrezikshme për jetën në çastin e shkakimit të saj, dënohet me burgim nga tre gjer në dhjetë vjet.

Po kjo vepër, kur është kryer kundër disa personave, kundër personit që është bashkëshort, ishbashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, ose kur ka sjellë si pasojë vdekjen, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Plagosje e rëndë në gjendje të tronditjes së fortë psikike (N 88/a) - Plagosja e rëndë, e kryer në gjendje të tronditjes të fortë psikike të çastit, shkaktuar nga dhuna ose fyerja e rëndë nga ana e të dëmtuarit, dënohet me burgim gjer në pesë vjet.

Plagosje e rëndë me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme (N88/b) - Plagosja e rëndë, e kryer me kapërcim të kufijve të mbrojtjes së nevojshme, dënohet me burgim gjer në tre vjet.

Plagosja e rëndë nga pakujdesia (N 91) - Plagosja e rëndë e kryer nga pakujdesia përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në një vit.

3. Dhuna në familje (N 130/a) - Rrahja, si dhe çdo vepër tjetër dhune, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cënimin e integritetit fizik, psiko-social dhe ekonomik të tij, dënohet me burgim gjer në dy vjet. Kanosja serioze për vrasje ose plagosje të rëndë, ndaj personit që është bashkëshort, ishbashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, me pasojë cënimin e integritetit psikik të tij, dënohet me burgim gjer në tre vjet.

Plagosja e kryer me dashje, ndaj personit që është bashkëshort, ish-bashkëshort, bashkëjetues apo ish-bashkëjetues, gjini e afërt ose krushqi e afërt me autorin e veprës penale, që ka shkaktuar paaftësi të përkohshme në punë më tepër se nëntë ditë, dënohet me burgim gjer në pesë vjet. Po këto vepra, të kryera në mënyrë të përsëritur, ose në praninë e fëmijëve, dënohen nga një deri në pesë vjet.

Analiza e veprave penale Kundër Personit

Kodi	Kategoria	Muaji					
		Shkurt 2022	Shkurt 2023	Shkurt 2024	Shkurt 2025	Janar 2026	Shkurt 2026
A	Kundër Personit						
A1	Vrasjet me dashje (Nr i rasteve)	3	2	5	5	2	2
A2	Të vdekur (Nr i viktimave)	3	2	5	5	2	2
A3	Plagosjet e rënda (Nr)	6	8	14	10	8	11
A4	Armëmbajtje pa leje (Nr)	120	101	133	149	124	138
A5	Dhuna në familje (Nr), 130/a	142	130	163	145	249	158
A6	Braktisja e fëmijëve të mitur	5	4	7	2	2	3
A7	Keqtrajtimi i të miturit (Nr)	6	3	5	3	4	4
A8	Krime seksuale (Nr)	15	6	19	9	10	8

Gjetjet Kryesore



Gjatë muajit shkurt 2026, në kategorinë e veprave penale "Vrasje me dashje" janë shënuar 2 raste dhe krahasuar me muajin shkurt 2025 gjatë të cilit ka pasur 5 raste, ka rënie me 3 raste, ndërsa krahasuar me muajin janar 2026, nuk ka pësuar ndryshim.



Numri i viktimave për veprën penale "Vrasje me dashje" ka shënuar 2 viktimë në muajin shkurt 2026 dhe krahasuar me muajin shkurt 2025, ka rënie me 3 raste, ndërsa krahasuar me muajin janar 2026, nuk ka pësuar ndryshim.



Plagosjet e rënda gjatë muajit shkurt 2026 kanë shënuar 11 raste dhe krahasuar me të njëjtin muaj të një viti më parë, ka rritje me 1 rast, gjithashtu krahasuar me muajin janar 2026, ka rritje me 3 raste më shumë.



Vepra penale "Armëmbajtje pa leje" në muajin shkurt 2026 kanë shënuar 138 raste dhe krahasuar me muajin shkurt 2025, gjatë të cilit janë shënuar 149 raste, ka rënie me 11 raste më pak, ndërsa krahasuar me muajin janar 2026, ka rritje me 14 raste më shumë.



Dhuna në familje gjatë muajit shkurt 2026 ka 158 raste dhe krahasuar me muajin shkurt 2025 ka rritje me 13 raste më shumë, ndërsa krahasuar me muajin janar 2026 gjatë të cilit ka pasur 249 raste, ka rënie me 91 raste më pak.



Gjatë muajit shkurt 2026, në kategorinë e veprës penale "Braktisja e fëmijëve të mitur" janë shënuar 3 raste dhe krahasuar me muajin shkurt 2025 ku janë shënuar 2 raste, ka rritje me 1 rast më shumë, ashtu sikurse krahasuar me muajin janar 2026.



Për muajin shkurt 2026 ka pasur 4 raste të veprës penale të "Keqtrajtimit i të miturve" dhe krahasuar me të njëjtin muaj të një viti më parë, ka rritje me 1 rast më shumë, ndërsa sikurse krahasuar me muajin janar 2026, nuk ka pësuar ndryshim.



Gjatë muajit shkurt 2026 janë shënuar 8 raste të krimeve seksuale dhe krahasuar me të njëjtin muaj të një viti më parë, ka rënie me 1 rast më pak, gjithashtu krahasuar me muajin janar 2026, ka rënie me 2 raste më pak.




Analiza Shpjeguese

Vepra Penale "Vrasje me Dashje"

Vrasjet me dashje gjatë analizës së muajit shkurt për periudhën pesëvjeçare 2022-2026, numri më i ulët i vrasjeve me dashje është shënuar në muajin shkurt 2023 me 2 raste, ndërsa numri më i lartë në muajin shkurt 2024 dhe 2025 me 5 raste. Krahasuar me mesataren e viteve të marrë në analizë e cila shënon 3 raste, në muajin shkurt 2026, ka rënie me 1 rast më pak. Në muajin shkurt 2026 janë shënuar 2 raste të veprës penale "Vrasje me dashje" dhe krahasuar me muajin shkurt 2025 ka rënie me 3 raste më pak. Krahasuar me muajin janar 2026, gjatë të cilit janë shënuar 2 raste, në muajin shkurt 2026, nuk ka pësuar ndryshim.

Përgjatë periudhës janar- shkurt 2026 janë shënuar 4 raste vepra penale "Vrasje me dashje", dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ka rënie me 6 raste më pak.

Analiza e Veprës Penale "Vrasje me Dashje"






Analiza e Numrit të Viktimave për Veprat Penale "Vrasje me Dashje"

Analiza Shpjeguese

Numri i Viktimave për Veprat Penale "Vrasje me Dashje"

Gjatë analizës së muajve shkurt për periudhën pesëvjeçare 2022-2026 për veprën penale "Vrasje me Dashje", numri më i lartë i viktimave është shënuar në muajin shkurt 2024 dhe 2025 me 5 viktimë, ndërsa numri më i ulët në muajin shkurt 2023 dhe 2026 me 2 viktimë. Niveli mesatar i periudhës pesëvjeçare shënon mesatarisht 3 viktimë dhe në muajin shkurt 2026, ka rënie me 1 rast më pak. Në muajin shkurt 2026 janë shënuar 2 viktimë dhe krahasuar me muajin shkurt 2025, ka rënie me 3 raste më pak. Në muajin janar 2026 ka pasur 2 viktimë dhe krahasuar me muajin shkurt 2026, nuk ka pësuar ndryshim.

Përgjatë periudhës janar- shkurt 2026 janë shënuar 4 raste vepra penale "Vrasje me dashje", dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ka rënie me 6 raste më pak.



Analiza Shpjeguese




Numri i Viktimave për Veprat Penale "Plagosje e Rëndë"

Gjatë periudhës shkurt 2022-2026 vlera më e lartë për veprën penale "Plagosje me dashje" është shënuar në muajin shkurt 2024 me 14 raste, ndërsa më e ulët është shënuar në muajin shkurt 2022 me 6 raste. Në krahasim me mesataren e muajve, e cila shënon 10 raste, në muajin shkurt 2026, ka rritje me 1 rast më shumë.

Krahasuar me muajin shkurt të vitit 2025, gjatë të cilit janë shënuar 10 raste, gjatë muajit shkurt të vitit 2026 ka pësuar rritje me 1 rast më shumë. Në shkurt 2026 ka pasur 11 raste vepra "Plagosje e rëndë", ose 3 raste më shumë, krahasuar me muajin janar 2026.

Përgjatë periudhës janar- shkurt 2026 janë shënuar 19 raste vepra penale "Plagosje e rëndë" dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ka rënie me 3 raste më pak.

Analiza e Veprave Penale "Plagosje e Rëndë"



Analiza Shpjeguese




Vepra penale "Armëmbajtje pa leje"

Gjatë periudhës 5-vjeçare shkurt 2022-2026 për veprën penale "Armëmbajtje pa leje" është shënuar numri më i lartë në muajin shkurt 2025 me 149 raste dhe numri më i ulët në muajin shkurt të vitit 2023 me 101 raste të evidentuara.

Krahasuar me mesataren e muajve shkurt të periudhës 2022-2026, e cila shënon përafërsisht 128 vepra penale, në muajin shkurt 2026 është shënuar rënie me 10 raste. Gjatë muajit shkurt 2026 janë shënuar 138 vepra penale dhe krahasuar me muajin shkurt 2025, ka rënie me 15 raste më pak. Krahasuar me muajin janar 2026 gjatë të cilit janë shënuar 124 raste, në muajin shkurt 2026, ka rritje me 14 raste më shumë.

Përgjatë periudhës janar- shkurt 2026 janë shënuar 262 raste vepra penale "Armëmbajtje pa leje" dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ka rënie me 46 raste më pak.

Analiza e veprës penale "Armëmbajtje pa leje"



Analiza Shpjeguese

Vepra penale "Dhuna në Familje"




Për periudhën 5-vjeçare shkurt 2022-2026, rastet e dhunës në familje nivelin më të lartë e kanë shënuar në muajin shkurt 2024 me 163 raste dhe nivelin më të ulët në muajin shkurt 2023 me 130 raste.

Mesatarja e viteve për muajt shkurt 2022-2026 shënon përafërsisht 148 raste për veprën penale për "Dhunë në familje" dhe në muajin shkurt 2026 janë shënuar 10 raste më shumë.

Gjatë muajit shkurt 2025 janë shënuar 145 vepra penale për dhunën në familje dhe krahasuar me muajin shkurt 2026 janë shënuar 158 raste ose 9% më shumë. Gjatë muajit janar 2026 janë shënuar 249 vepra penale dhe në muajin shkurt 2026, ka rënie me 36.5% më pak e veprës penale "Dhunë në familje".

Përgjatë periudhës janar- shkurt 2026 janë shënuar 407 raste vepra penale "Dhuna në familje", dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ka rritje me 68 raste më shumë.

Analiza e veprës penale "Dhuna në Familje"



Analiza e veprës penale "Braktisja e Fëmijëve të Mitur"




Analiza Shpjeguese

Vepra penale "Braktisja e Fëmijëve të Mitur"

Gjatë periudhës 5-vjeçare shkurt 2022-2026, rastet e braktisjes së fëmijëve të mitur kanë qenë në nivelin më të lartë në muajin shkurt të vitit 2024 ka shënuar 7 raste dhe niveli më i ulët në muajin shkurt të vitit 2025 me 2 raste të shënuar.

Mesatarja e periudhës së marrë në shqyrtim shënon 4 raste të veprës penale "Braktisja e fëmijëve të mitur" dhe në muajin shkurt 2026, është shënuar 1 rast më pak. Në muajin shkurt 2025 janë evidentuar 2 vepra penale për braktisjen e fëmijëve dhe krahasuar me muajin shkurt 2026, ka rritje me 1 rast më shumë. Në krahasim me muajin e mëparshëm janar 2026 gjatë të cilit është shënuar 2 raste, në muajin shkurt 2026, ka rritje me 1 rast më shumë.

Përgjatë periudhës janar- shkurt 2026 janë shënuar 5 raste vepra penale "Braktisje e fëmijëve të mitur", dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ka rënie me 1 rast më pak.






Analiza e veprës penale "Keqtrajtimi i të Miturve"

Analiza Shpjeguese

Vepra penale "Keqtrajtimi i të Miturve"

Rastet e keqtrajtimit të të miturve, gjatë periudhës së marrë në analizë shkurt 2022-2026, kanë shënuar nivelin më të lartë në muajin shkurt 2022 me 6 raste dhe nivelin më të ulët në muajin 2023 dhe 2025 me 3 raste. Mesatarja e muajve shkurt 2022-2026, shënon përafërsisht 4 raste, të veprës penale "Keqtrajtimi i të Miturve" dhe në muajin shkurt 2026, nuk ka pësuar ndryshim. Në krahasim me muajin shkurt 2025 gjatë të cilit ka pasur 3 raste të keqtrajtimit të të miturve, në muajin shkurt 2026, ka rritje me 1 rast më shumë. Në raport me muajin e mëparshëm janar 2026 gjatë të cilit janë 4 vepra penale, në muajin shkurt 2026, nuk ka pësuar ndryshim.

Përgjatë periudhës janar- shkurt 2026 janë shënuar 8 raste vepra penale "Keqtrajtimi i të Miturve" dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, nuk ka pësuar ndryshim.



Analiza Shpjeguese




Vepra penale "Krime Seksuale"

Rastet e veprave penale "Krime Seksuale", gjatë muajit shkurt 2022-2026, kanë shënuar vlerën më të lartë në shkurt të vitit 2024 me 19 raste, ndërsa vlerën më të ulët në muajin shkurt 2023 me 6 raste. Në muajin shkurt 2026 shënohen 8 raste dhe krahasuar me muajin shkurt 2025, ka rënie 1 rast më pak. Gjithashtu krahasuar me mesataren e marrë në shqyrtim, e cila shënon 11 raste, në muajin shkurt 2026 ka rënie me 3 raste më pak.

Në raport krahasimor me muajin paraardhës, janar 2026 gjatë të cilit janë shënuar 10 raste, në muajin shkurt 2026, ka rënie me 2 raste më pak.

Përgjatë periudhës janar- shkurt 2026 janë shënuar 18 raste vepra penale "Krime Seksuale" dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ka rritje me 2 raste më shumë.

Analiza e veprës penale "Krime Seksuale"





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Analiza mujore e veprave penale kundër pasurisë

Shkurt 2026

Përmbledhje e neneve të veprave penale kundër pasurisë

- 1. Vjedhja e bankave dhe arkave të kursimit (N.136)** - Vjedhja e bankave dhe e arkave të kursimit dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë ose ka sjellë pasoja të rënda, dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.
- 2. Vjedhja me dhunë (N.139)** - Vjedhja e pasurisë e shoqëruar me përdorim dhune dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.
- 3. Vjedhja me armë (N.140)** - Vjedhja e pasurisë, e shoqëruar me mbajtjen e armëve dhe municioneve luftarake ose me përdorimin e tyre, dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.
- 4. Vjedhje me pasojë vdekjen (N.141)** - Vjedhja e pasurisë, kur është shoqëruar me dhunime që kanë sjellë vdekjen e personit, dënohet me burgim nga pesëmbëdhjetë gjer në njëzet e pesë vjet ose me burgim të përjetshëm.
- 5. Shkatërrimi i pronës me eksploziv (N.152)** - Shkatërrimi apo dëmtimi me dashje i pronës me eksploziv dënohet me gjobë ose me burgim gjer në pesë vjet. Kur nga vepra penale kanë ardhur pasoja të rënda materiale, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet. Kur janë shkaktuar pasoja të rënda për jetën e shëndetin e njerëzve, dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.

Analiza e veprave penale kundër pasurisë

Kodi	Kategoria	Muaji					
		Shkurt 2022	Shkurt 2023	Shkurt 2024	Shkurt 2025	Janar 2026	Shkurt 2026
B	Kundër Pasurisë						
B1	Gjobëvënie	0	2	2	3	2	4
B2	Vjedhje (N. 139-140)	4	9	8	7	6	7
B3	Vjedhje e mjeteve motorike	10	9	17	9	4	6
B4	Vjedhje e bankave dhe arkave të kursimit	2	0	0	0	2	2
B2.1	Vjedhje me dhunë	2	9	6	7	5	7
B2.2	Vjedhje me armë	2	0	2	0	1	0
B7	Vjedhje me pasojë vdekjen	0	0	0	0	0	0
B8	Shkatërrimi i pronës me eksploziv	2	1	4	3	1	1

Gjetjet kryesore



Për muajin shkurt 2026, vepra penale "Vjedhje (139/140)" ka shënuar 7 raste të evidentuara. Kjo kategori veprash penale ka shënuar të njëjtin trend, në krahasim me muajin shkurt 2025, ndërsa, krahasuar me muajin paraardhës, shënohet rritje me 1 rast.



Në muajin shkurt 2026 janë shënuar 7 raste të veprës penale "Vjedhje me dhunë", është shënuar i njëjti numër rastesh, në krahasim me muajin shkurt 2025. Në krahasim me muajin janar 2026, ku janë shënuar 5 raste të veprës penale "Vjedhje me dhunë", në muajin shkurt 2026 vihet re rritje me 2 raste.



Në muajin shkurt 2026 nuk është shënuar asnjë rast i veprës penale "Vjedhje me armë", shënohet i njëjti trend krahasuar me të njëjtin muaj të një vit më parë, gjithashtu, në krahasim me muajin paraardhës janar 2026, vihet re rënie me asnjë rast.



Për veprën penale "Vjedhje e Bankave dhe Arkave të Kursimit", në muajin shkurt 2026, janë evidentuar 2 raste, duke shënuar rritje, krahasuar me të njëjtin muaj të një viti më parë, ndërsa krahasuar me muajin paraardhës vihet re i njëjti trend.



Gjatë muajit shkurt 2026, nuk është shënuar asnjë rast i veprës penale e vjedhjeve me pasojë vdekjen, vihet re i njëjti trend, krahasuar me të njëjtin muaj të një viti më parë, gjithashtu krahasuar me muajin paraardhës janar 2026, nuk ka pasur ndryshime.



Gjatë muajit shkurt 2026 është shënuar 1 rast i veprës penale "Shkatërrimi i pronës me eksploziv", krahasuar me muajin shkurt 2025, vihet re rënie me 2 raste, ndërsa krahasuar me muajin e kaluar kjo vepër penale ka shënuar të njëjtin numër rastesh.



Në muajin shkurt 2026, janë evidentuar 4 raste të veprës penale "Gjobëvënia", vihet re rritje me 1 rast, krahasuar me muajin shkurt të vitit 2025, ku janë evidentuar 3 raste të kësaj vepre penale. Në krahasim me muajin paraardhës janar 2026, në muajin shkurt 2026 është shënuar rritje me 2 raste.



Në shkurt 2026 vihet re rënie e numrit të veprave penale "Vjedhje e mjeteve motorike" me 3 raste në krahasim me muajin shkurt 2025, ndërsa në krahasim me muajin janar 2026, vihet re rritje me 2 raste.

Analiza e veprës penale "Vjedhje (N.139-140)"

Analiza shpjeguese



Vepra penale "Vjedhje (N.139-140)"

Numri më i ulët i veprave penale "Vjedhje" është shënuar në muajin shkurt të vitit 2022, me 4 raste të evidentuara, ndërsa numri më i lartë është shënuar në muajin shkurt të vitit 2023, me 9 raste të evidentuara.

Gjatë muajit shkurt 2026 janë evidentuar 7 vepra penale duke shënuar të njëjtin trend, krahasuar me nivelin mesatar të muajve shkurt 2022 - shkurt 2026 e cila shënon mesatarisht 7 raste.

Krahasuar me muajin shkurt të vitit 2025, në shkurt të vitit 2026, shënohet i njëjti numër rastesh të veprës penale "Vjedhja".

Në muajin janar të vitit 2026 janë evidentuar 6 raste të veprës penale vjedhja, në muajin shkurt të vitit 2026, vihet re rritje me 1 rast.



Analiza e veprës penale "Vjedhje (N.139-140)"


Analiza shpjeguese

Vepra penale "Vjedhje (N.139-140)"


Referuar të dhënave komulative, për veprën penale "Vjedhje", për periudhën janar-shkurt 2025 dhe janar-shkurt 2026, vihet re vihet re rritje me 2 raste të evidentuara.

Pesha e vjedhjeve me dhunë është më e madhe në kategorinë e veprës penale "Vjedhje", gjatë periudhës 2022-2026. Gjatë periudhës së marrë në shqyrtim vihet re se në muajin shkurt të vitit 2026 vepra penale e "Vjedhjes me dhunë" zë 100% të peshës, ndërsa "Vjedhje me armë" në muajin shkurt të vitit 2026, zë peshën më të ulët me 0% të peshës. Gjithashtu, për sa i përket muajit shkurt 2025 vepra penale të "Vjedhjes me dhunë" zë 100% të peshës dhe "Vjedhje me armë" zë 0% të peshës.

**Kategoritë e veprës penale "Vjedhje(N.139-140)"
(Janar-Shkurt 2025 & Janar-Shkurt 2026) , Kumulative**



**Kategoritë e veprës penale "Vjedhje (N.139-140)",
(Muajt Shkurt 2022 - 2026)**



Analiza shpjeguese

Vepra penale "Vjedhje me Dhunë"




Në periudhën shkurt 2022-shkurt 2026, rastet e vjedhjeve me dhunë kanë shënuar nivelin më të lartë në muajin shkurt të vitit 2023 me 9 raste dhe nivelin më të ulët në muajin shkurt të vitit 2022, me 2 raste të evidentuara. Në krahasim me mesataren e periudhës së analizuar që shënon mesatarisht 6 raste për muajt shkurt 2022-shkurt 2026, në muajin shkurt të vitit 2026, vihet re rritje me 1 rast.

Referuar krahasimit të muajit shkurt 2026 me muajin shkurt të vitit të kaluar, numri i veprave penale "Vjedhje me dhunë", shënon të njëjtin trend.

Duke iu referuar ndryshimit mujor të vjedhjeve me dhunë në muajin shkurt 2026, në raport me muajin janar 2026, vihet re rritje me 2 raste.

Referuar të dhënave kumulative për veprën penale "Vjedhje me dhunë", gjatë periudhës janar-shkurt 2026 shënon rritje me 1 rast, krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Analiza e Veprës Penale "Vjedhje me dhunë"



Analiza shpjeguese




Vepra penale "Vjedhje me armë"

Gjatë analizës së periudhës pesëvjeçare 2022-2026, numri i vjedhjeve me armë ka shënuar nivelin më të lartë në muajin shkurt të viteve 2022 dhe 2024, me 2 raste të evidentuar, ndërsa në muajt e tjerë, nuk është evidentuar asnjë rast i kësaj vepre penale.

Në muajin shkurt 2026, nuk është shënuar asnjë rast i numrit të veprave penale vjedhje me armë, vihet re i njëjti trend, në krahasim me të njëjtin muaj një viti më parë.

Duke iu referuar ndryshimit mujor të veprës penale "Vjedhje me armë", gjatë muajit shkurt 2026, vihet re rënie me 1 rast, krahasuar me muajin paraardhës janar 2026. Referuar të dhënave kumulative, për veprën penale "Vjedhje me armë", vihet re se gjatë periudhës janar-shkurt 2026, është evidentuar 1 rast të veprës së vjedhjeve me armë duke shënuar rritje me 1 rast, krahasuar me të njëjtin periudhë të një viti më parë.

Analiza vepra penale "Vjedhje me armë"



Analiza e veprës penale "Shkatërrim i pronës me eksploziv"

Analiza shpjeguese




Vepra penale "Shkatërrim i pronës me eksploziv"

Në periudhën shkurt 2022 - shkurt 2026, rastet e veprës penale "Shkatërrim i pronës me eksploziv", kanë shënuar nivelin më të lartë në muajin shkurt të vitit 2024 me 4 raste, ndërsa në muajin shkurt të viteve 2023 dhe 2026, vihet re në nivelin më të ulët me nga 1 rast të evidentuar.

Përsa i përket veprës penale "Shkatërrim i pronës me eksploziv", në muajin shkurt 2026 është evidentuar 1 rast i kësaj vepre penale, në krahasim me muajin shkurt 2025, vihet re rënie me 2 raste, gjithashtu, krahasuar me mesataren e muajve shkurt të viteve 2022-2026, vihet re rënie me 1 rast.

Referuar ndryshimit mujor të veprës penale "Shkatërrim i pronës me eksploziv", gjatë muajit shkurt 2026, vihet re i njëjti trend, në krahasim me muajin paraardhës janar 2026.

Referuar të dhënave kumulative vihet re se gjatë periudhës janar-shkurt 2026, vihet re rënie me 6 raste, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.



Analiza e veprës penale "Vjedhje e mjeteve motorike"




Analiza shpjeguese

Vepra penale "Vjedhje e mjeteve motorike"

Në periudhën shkurt 2022 - shkurt 2026, rastet e veprës penale "Vjedhje e mjeteve motorike" kanë shënuar nivelin më të lartë në shkurt të vitit 2024 me 17 raste dhe nivelin më të ulët në muajin shkurt të vitit 2026, me 6 raste të evidentuara. Gjatë muajit shkurt 2026, janë evidentuar 6 raste të vjedhjeve të mjeteve motorike, vihet re rënie me 3 raste, krahasuar me muajin shkurt të vitit të kaluar, ndërsa, krahasuar me mesataren e muajve shkurt e cila shënon mesatarisht 10 vepra, në shkurt 2026 shënohet rënie me 4 raste.

Në krahasim me muajin janar 2026 ku janë shënuar 4 vepra të vjedhjes së mjeteve motorike, gjatë muajit shkurt 2026 është shënuar rritje me 2 raste.

Referuar të dhënave kumulative për periudhën janar-shkurt 2025 dhe janar-shkurt 2026, në janar-shkurt të 2026 vihet re rënie me 37.5% të veprave penale "Vjedhje e mjeteve motorike".



Analiza shpjeguese




Vepra penale "Gjobëvënie"

Në periudhën shkurt 2022- shkurt 2026, numri i gjobëvënieve ka shënuar vlerën më të lartë në muajin shkurt të vitit 2026 me 4 të tilla, ndërsa niveli më i ulët është shënuar në muajin shkurt të vitit 2022 me 2 vepra penale të evidentuar. Gjatë muajit shkurt 2025 janë evidentuar 3 raste të veprës penale "gjobëvënia", në muajin shkurt 2026, vihet re rritje me 1 rast. Krahasuar me mesataren e muajve shkurt të viteve 2022-2026 e cila shënon mesatarisht 2 raste, vihet re rritje me 2 raste.

Në muajin janar 2026 janë shënuar 2 raste të veprës penale gjobëvënia, në muajin shkurt 2026, shënohet rritje me 2 raste.

Referuar të dhënave kumulative, gjatë periudhës janar-shkurt 2026, vihet re rritje me 20%, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Analiza e veprës penale "Gjobëvënie"





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Vepra penale ekonomiko-financiare

Shkurt 2026

Vepra penale ekonomiko-financiare

1. Kontrabanda me mallra të ndaluara ose të kufizuara (N.171) - Importimi, eksportimi ose tranzitimi i paligjshëm i mallrave të ndaluara ose të kufizuara që hyjnë e dalin në Republikën e Shqipërisë, kryer me çdo mënyrë a mjet qoftë, dënohen me burgim deri në dhjetë vjet.

2. Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale (N.287) - Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, nëpërmjet:

- a) këmbimit ose transferimit të pasurisë, me qëllim fshehjen ose mbulimin e origjinës së paligjshme të saj, duke ditur se kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;
- b) fshehjes ose mbulimit të natyrës së vërtetë, burimit, vendndodhjes, disponimit, zhvendosjes, pronësisë ose të drejtave në lidhje me pasurinë, duke ditur që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;
- c) fitimit të pronësisë, posedimit ose përdorimit të pasurisë, duke e ditur në çastin e marrjes në dorëzim të saj, që kjo pasuri është produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale;
- ç) kryerjes së veprimeve financiare ose transaksioneve të copëzuara për shmangien nga raportimi, sipas legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave;
- d) investimit në veprimtari ekonomike ose financiare të parave a sendeve, duke ditur se janë produkte të veprës penale ose veprimtarisë kriminale.

Analiza e veprave penale ekonomike-financiare

Kodi	Kategoria	Muaji					
		Shkurt 2022	Shkurt 2023	Shkurt 2024	Shkurt 2025	Janar 2026	Shkurt 2026
C	Krime ekonomike-financiare						
C1	Kontrabanda e mallrave	42	44	36	44	35	62
C2	Falsifikim (Nr)	75	62	65	82	49	85
C3	Pastrimi i parave (N.287) - Sekuestrime vlerë (Euro)	111,593	370,450	270,000	122,582	0	0
C4	Pastrimi i parave (N.287) - Nr raste referuar	29	42	48	39	53	51

Gjetjet kryesore



Gjatë muajit shkurt 2026, janë evidentuar 62 raste të kontrabandës së mallrave, shënohet rritje me 18 raste, krahasuar me muajin shkurt të vitit 2025. Në krahasim me muajin janar 2025, janë shënuar 27 raste më shumë të kësaj vepre penale.



Numri i rasteve të veprave penale "Pastrimi i parave (N.287)" gjatë muajit shkurt të vitit 2026, ka shënuar rritje me 12 raste, krahasuar me muajin shkurt të vitit 2025, ndërsa krahasuar me muajin paraardhës shënohet rënie me 2 raste.



Vepra penale "Falsifikimi", në muajin shkurt 2026 ka shënuar rritje me 3 raste, krahasuar me muajin shkurt 2025, gjithashtu krahasuar me muajin janar 2026 shënohet rritje me 36 raste.

Analiza e veprave penale "Kontrabanda e Mallrave"

Analiza shpjeguese




Vepra penale të kontrabandës së mallrave

Për periudhën shkurt 2022-2026, veprat penale të kategorisë "Kontrabanda e Mallrave", vlera më e ulët shënohet në muajin shkurt të vitit 2024 me 36 raste.

Gjatë muajit shkurt 2026 kanë rezultuar 62 raste të veprës penale "Kontrabanda e Mallrave", 16 raste më shumë se niveli mesatar i periudhës së analizuar që shënon mesatarisht 46 raste të tilla në muaj, gjithashtu krahasuar me muajin shkurt 2025, vihet re rritje me 18 raste. Në krahasim me një muaj më parë, në shkurt 2026, vihet re rritje me 27 raste.

Referuar

të dhënave kumulative gjatë periudhës janar-shkurt 2026 krahasuar me periudhën janar-shkurt 2025, rezulton një rritje me 4% të numrit të rasteve.



Analiza shpjeguese




Vepra penale të falsifikimit

Për periudhën shkurt 2022-2026, vepra penale "Falsifikimi", ka pasur vlerën më të lartë në muajin shkurt 2026 me 85 raste, ndërkohë që vlera më e ulët është shënuar në muajin shkurt 2023 me 62 raste të evidentuara. Gjatë muajit shkurt 2026 kanë rezultuar 85 raste të veprës penale "Falsifikimi", vihet re rritje me 3 raste, krahasuar me muajin shkurt 2025.

Në krahasim me muajin janar të vitit 2025, rezulton se në muajin shkurt 2026 janë evidentuar 36 raste më shumë.

Referuar të dhënave kumulative, gjatë periudhës janar-shkurt 2026 është shënuar një rënie me 1 vepër penale, krahasuar me të njëjtë periudhë të vitit 2025.

Analiza e Veprës Penale "Falsifikime"






Analiza shpjeguese

Vepra penale 'Pastrimi i parave (N.287)-Sekuestrime vlerë (euro)

Për periudhën shkurt 2022-2026, sekuestrimet për veprat penale të kategorisë 'Pastrimi i Parave (N.287)', kanë pasur nivelin më të lartë në muajin shkurt 2023 me 370,450 Euro sekuestrime dhe vlera më e ulët është shënuar në muajin shkurt të vitit 2026, në të cilat nuk ka pasur sekuestrime.

Referuar të dhënave kumulative, gjatë periudhës shkurt të vitit 2026, ka pasur një rënie të sekuestrimeve, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.



Analiza e veprës penale "Pastrimi i parave-Nr"




Analiza shpjeguese

Vepra penale "Pastrimi i parave" (N.287) - Nr raste referuar

Për periudhën shkurt 2022-2026, veprat penale të kategorisë "Pastrimi i Parave" (N.287), kanë pasur nivelin më të lartë në muajin shkurt të 2026 me 51 raste të shënuara dhe vlera më e ulët është shënuar në Shkurt të vitit 2022 me 29 raste. Gjatë muajit shkurt 2026, vihet re rritje me 12 raste, në krahasim me muajin shkurt 2025, gjithashtu, krahasuar me mesataren e muajve shkurt të viteve 2022-2026, e cila shënon mesatarisht 42 raste, shënohet rritje me 9.

Në krahasim me muajin e mëparshëm, gjatë muajit shkurt 2026 evidentohet rënie me 2 raste.

Referuar të dhënave kumulative, vihet re se gjatë periudhës janar-shkurt 2026, shënohet rritje me 44% e numrit të rasteve të pastrimit të parave, krahasuar me të njëjtën periudhë një viti më parë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Analiza mujore e veprave penale të trafikeve të paligjshme

Shkurt 2026

Përmbledhje e neneve të veprave penale të trafikeve të paligjshme

1. Trafikimi i personave të rritur (N.110/a)-Rekrutimi, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e personave nëpërmjet kërcënimit ose përdorimit të forcës apo formave të tjera të shtrëngimit, rrëmbimit, mashtrimit, shpërdorimit të detyrës ose përfitimit nga gjendja shoqërore, fizike apo psikike ose dhënies apo marrjes së pagesave ose përfitimeve për të marrë pëlqimin e personit që kontrollon një person tjetër, me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit të të tjerëve ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, të skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, të vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, si brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, dënohen me burgim nga tetë deri në pesëmbëdhjetë vjet. Kur kjo vepër kryhet ndaj një personi të rritur të gjinisë femërore dënohet me burgim nga dhjetë deri në pesëmbëdhjetë vjet. Organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të personave dënohen me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet. Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim, më shumë se një herë, shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike ndaj të dëmtuarit, për të kryer veprime të ndryshme, sjell pasoja të rënda për shëndetin, ose rrezikon jetën e tij, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm. Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimi me burgim shtohen me ¼ e dënimit të dhënë.

2. Shfrytëzim Prostitucioni (N.114)-Shtytja, ndërmjetësimi ose marrja shpërblim për ushtrimin e prostitucionit dënohet me burgim nga dy deri në pesë vjet. Po kjo vepër, kur kryhet me të mitur, ndaj disa personave, me persona me të cilët ekzistojnë lidhje të afërta gjinie, krushqie, kujdestarie, apo duke përfituar nga raportet zyrtare, ose kryhet në bashkëpunim apo më shumë se një herë, ose nga persona të ngarkuara me funksione shtetërore dhe publike, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

3. Trafikimi i të miturve (N.128)- Rekrutimi, shitja, transportimi, transferimi, fshehja ose pritja e të miturve me qëllim shfrytëzimin e prostitucionit ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, skllavërimit ose formave të ngjashme me skllavërimin, vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit, dënohen me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet. Organizimi, drejtimi dhe financimi i trafikimit të të miturve dënohen me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet. Kur kjo vepër kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, apo shoqërohet me keqtrajtimin dhe detyrimin me dhunë fizike a psikike të të dëmtuarit, për të kryer veprime të ndryshme, ose sjell pasoja të rënda për shëndetin, dënohet me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet. Kur vepra ka sjellë si pasojë vdekjen e të dëmtuarit, dënohet me burgim jo më pak se njëzet vjet ose me burgim të përjetshëm. Kur vepra penale kryhet nëpërmjet shfrytëzimit të funksionit shtetëror ose shërbimit publik, dënimi me burgim shtohen me ¼ e dënimit të dhënë.

4. Trafikimi i mjeteve motorike (N.141/a)-Importimi, eksportimi, tranzitimi dhe tregtimi në kundërshtim me ligjin, i mjeteve motorike të vjedhura, me qëllim fitimi material ose çdo përfitim tjetër, dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, ose sjell pasoja të rënda, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

5. Trafikimi i armëve dhe municioneve (N.278/a)-Importimi, eksportimi, tranzitimi dhe tregtimi, në kundërshtim me ligjin, i armëve dhe municionit luftarak, ose i pjesëve përbërëse të tyre me qëllim fitimi material ose çdo përfitim tjetër, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë ose sjell pasoja të rënda, dënohet me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.

Analiza e veprave penale të trafiqeve të paligjshme

Kodi	Kategoria	Muaji					
		Shkurt 2022	Shkurt 2023	Shkurt 2024	Shkurt 2025	Janar 2026	Shkurt 2026
Ç	Trafiqet e Paligjshme						
Ç1	Numri i veprave penale të evidentuara	94	91	70	119	90	90
Ç2	Numri i autorëve	121	119	83	143	115	91
Ç3	Trafikimi i të rriturve	0	0	2	11	0	1
Ç4	Shfrytëzim prostitucioni	6	6	12	8	4	8
Ç5	Trafikimi i të miturve	0	2	1	4	0	0
Ç6	Trafikimi i mjeteve motorike	17	8	17	18	15	11
Ç7	Trafikimi i armëve dhe municioneve	4	2	8	2	3	2

Gjetjet kryesore



Gjatë muajit shkurt 2026, është shënuar një rënie e numrit të trafiqeve të paligjshme me 29 vepra penale ose 24% raste më pak, në krahasim me muajin shkurt 2025, ndërsa në krahasim me muajin paraardhës janar 2026, vihet re i njëjti numër rastesh.



Gjatë muajit shkurt 2026, ka një rënie me 52 autorë më pak në veprat penale të trafiqeve të paligjshme në krahasim me muajin shkurt 2025, gjithashtu në krahasim me muajin dhjetor 2025 është shënuar një rënie me 24 autorë.



Vepra penale "Shfrytëzim prostitucioni", muaji shkurt 2026 në krahasim me muajin shkurt 2025, shënon të njëjtin numër rastesh të evidentuara, ndërsa, krahasuar me muajin janar 2026, shënohet rritje me 4 vepër penale.



Vepra penale "Trafikimi i të miturve", në muajin shkurt 2026 në krahasim me muajin shkurt 2025 shënon rënie me 4 raste të evidentuar, ndërsa në krahasim me muajin paraardhës janar 2026, situata nuk ka ndryshuar.



Vepra penale "Trafikimi i mjeteve motorike", gjatë muajit shkurt 2026 shënon rënie me 7 raste, në krahasim me muajin shkurt 2025, ndërsa në krahasim me muajin janar 2026, vihet re rënie me 4 raste.



Vepra penale "Trafikimi i armëve dhe municioneve", gjatë muajit shkurt 2026 shënon të njëjtin numër rastesh, krahasuar me muajin shkurt 2025, gjithashtu, në krahasim me muajin janar 2026, evidentohet rënie me 1 rast.

Analiza e veprave penale të evidentuara në trafiqet e paligjshme

Analiza shpjeguese



Vepra penale 'Trafiqet e paligjshme'

Duke iu referuar krahasimit ndër vite të muajit shkurt për periudhën 2022-2026, kategoria e veprave penale "Trafiqet e paligjshme" ka shënuar numrin më të lartë në muajin shkurt 2025, me 119 raste, ndërsa numri më i ulët i rasteve është arritur në shkurt 2024 me 70 vepra. Në muajin shkurt 2026 janë shënuar 90 vepra penale, krahasuar me muajin shkurt 2025, shënohet rënie me 29 vepra ose 24% raste më pak. Krahasuar me mesataren e periudhës së analizuar për muajt shkurt 2022-2026, e cila shënon mesatarisht 93 vepra, në muajin shkurt 2026, vihet re një rënie me 3 raste.

Në krahasim me muajin paraardhës janar 2026 ku janë evidentuar 90 vepra penale, në muajin shkurt 2026 vihet re i njëjti trend i veprave penale në fushën e trafiqeve të paligjshme.

Shënim: Në analizë janë përfshirë:

- Trafikimi i të rriturve
- Shfrytëzim prostitucioni
- Trafikimi i të miturve
- Trafikimi i mjeteve motorike
- Trafikimi i armëve dhe i municionit



Analiza e veprave Penale të evidentuara në trafiqet e paligjshme



Analiza shpjeguese

Vepra penale 'Trafiqet e paligjshme'

Referuar të dhënave kumulative për periudhën janar-shkurt 2026 janë shënuar 180 raste të veprave penale të trafiqeve të paligjshme, duke shënuar një rënie me 23% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë në të cilën janë shënuar 235 vepra penale.

Në muajin shkurt 2026 shohim që përqindjen më të madhe të veprave penale të evidentuara në trafiqet e paligjshme e zë kategoria "Trafikimi i mjeteve motorike" me 12%, ndërsa vepra penale "Trafikim i të miturve", zë peshën më të vogël me 0% .

Nëse i referohemi muajit shkurt 2025, kategoria e veprës penale me më shumë raste të evidentuara është vepra "Trafikimi i mjeteve motorike" me 15% të rasteve, ndërsa vepra penale "Trafikimi i armëve dhe municioneve" zë peshën më të vogël me 2% të peshës.






Analiza e numrit të autorëve në trafiqet e paligjshme

Analiza shpjeguese

Autorë në Trafiqet e Paligjshme

Duke iu referuar grafikut, numri i autorëve në veprat penale të trafiqeve të paligjshme ka arritur nivelin më të lartë në muajin shkurt 2025 me 143 të tillë, ndërkohë që niveli më i ulët është shënuar në shkurt të vitit 2024, me 83 autorë. Krahasuar me mesataren e muajve shkurt 2022-2026 e cila shënon mesatarisht 111 autorë të veprave penale trafiqe të paligjshme, në shkurt të 2025 shënohet një rënie me 20 autorë. Në krahasim me muajin shkurt 2025, ku janë evidentuar 143 autorë, në shkurt 2026 shënohet rënie me 52 autorë ose 36% autorë më pak në trafiqet e paligjshme. Në krahasim me muajin janar 2025, ku janë evidentuar 115 autorë, në muajin shkurt 2026 shënohet rënie me 24 autorë ose 21% më pak autorë në trafiqet e paligjshme.

Referuar të dhënave kumulative për periudhën janar-shkurt 2026 janë evidentuar 206 autorë veprash penale të trafikimit të paligjshme, shënohet rënie me 29% autorë më pak, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.



Analiza e veprës penale "Trafikimi i të rriturve"




Analiza shpjeguese

Vepra penale "Trafikimi i të Rriturve"

Referuar grafikut për veprën penale "Trafikimi i të rriturve", për periudhën e marrë në studim 2022-2026, vihet re se në muajin shkurt të vitit 2025 janë evidentuar 11 raste të trafikimit të të rriturve, ndërsa në muajt shkurt të viteve 2022 dhe 2023 nuk është shënuar asnjë rast i veprës penale "Trafikimi i të rriturve", duke shënuar dhe nivelin më të ulët.

Në muajin shkurt 2026 është evidentuar një rast i trafikimit të të rriturve, vihet re rënie me 10 raste, krahasuar me muajin shkurt 2025.

Në muajin janar 2026 nuk është evidentuar asnjë rast i veprës penale për trafikimin e të rriturve, në muajin shkurt 2026 shënohet rritje me 1 rast.



Analiza e veprës penale "Shfrytëzim për prostitucion"




Analiza shpjeguese

Vepra penale "Shfrytëzim për prostitucion"

Referuar analizës së veprës penale "Shfrytëzim për prostitucion" për muajin shkurt 2022-2026, në muajin shkurt të vitit 2024 është shënuar numri më i lartë i rasteve të "Shfrytëzimit të prostitucionit", me 12 vepra penale, ndërsa në muajin shkurt të viteve 2022 dhe 2023 shënohet numri më i ulët i kësaj vepre penale me 6 raste. Në muajin shkurt 2026 janë shënuar 8 raste të veprës penale të shfrytëzimit për prostitucion, duke shënuar të njëjtin trend, krahasuar me nivelin e mesatares së periudhës shkurt 2022-2026, ku shënohen mesatarisht 8 raste. Në muajin shkurt 2025 janë evidentuar 8 raste të shfrytëzimit të prostitucionit, në muajin shkurt 2026 shënohet i njëjti trend.

Në muajin shkurt 2026, krahasuar me muajin paraardhës janar 2026, vihet re rritje me 4 rast të veprës penale "Shfrytëzim për prostitucion".

Referuar të dhënave kumulative, në periudhën janar-shkurt 2026 janë shënuar 4 vepra penale më pak të shfrytëzimit të prostitucionit, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.



Analiza e veprës penale " Trafikimi i mjeteve motorike"

Analiza shpjeguese




Vepra penale "Trafikim i mjeteve motorike"

Vepra penale e trafikimit të mjeteve motorike ka shënuar numrin më të lartë në shkurt të vitit 2025 me 18 raste të evidentuara, ndërsa numri më i ulët i kësaj vepre penale është shënuar në shkurt të vitit 2023 me 8 raste të evidentuara.

Gjatë muajit shkurt 2026 shënohet rënie me 7 raste, në krahasim me muajin shkurt 2025, gjithashtu edhe në krahasim me mesataren e periudhës shkurt 2022-2026, evidentohet rënie me 3 raste.

Në krahasim me muajin janar 2026 gjatë të cilit janë evidentuar 15 vepra penale, në muajin shkurt 2026, shënohet rënie me 27% e veprës penale "Trafikim i mjeteve motorike".

Referuar të dhënave kumulative për periudhën janar-shkurt 2026 janë evidentuar 26 raste të trafikimit të mjeteve motorike, duke shënuar rënie me 45%, në krahasim me të njëjtën periudhë të një viti më parë.



Analiza e veprës "Trafikimi i armëve dhe municioneve"

Analiza shpjeguese




Vepra penale "Trafikimi i armëve dhe municioneve"

Vepra penale "Trafikimi i armëve dhe municioneve", gjatë muajve shkurt të periudhës 2022-2026, ka shënuar nivelin më të lartë në muajin shkurt 2024, me 8 raste të evidentuara, ndërsa në muajin shkurt të viteve 2023, 2025 dhe 2026 evidentohet niveli më i ulët me 2 raste.

Në muajin shkurt 2026 janë evidentuar 2 raste të veprës penale "Trafikim i armëve dhe municioneve" duke shënuar të njëjtin trend, krahasuar me muajin shkurt 2025, ndërsa krahasuar me mesataren e muajve shkurt 2022-2026 e cila shënon mesatarisht 3.6 raste, shënohet rënie.

Për sa i përket ndryshimit mujor për këtë vepër penale në shkurt 2026 evidentohet rënie 1 rast, krahasuar me muajin paraardhës janar 2026.

Duke iu referuar të dhënave kumulative për periudhën janar-shkurt 2026 janë evidentuar 3 raste më shumë të trafikimit të armëve dhe municioneve.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Vepra penale në fushën e drogave
Shkurt 2026**

Vepra Penale në Fushën e Drogave

1.Prodhimi dhe shitja e narkotikëve (N.283) - Shitja, ofrimi për shitje, dhënia ose marrja në çdo formë, shpërndarja, tregtimi, transportimi, dërgimi, dorëzimi, si dhe mbajtja, përveç rastit të përdorimit vetjak dhe në doza të vogla, të substancave narkotike dhe psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike, në kundërshtim me ligjin ose në kapërcim të përmbajtjes së tyre, dënohet me burgim nga pesë deri në dhjetë vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet. Organizimi, drejtimi apo financimi i kësaj veprimtarie, dënohen me burgim nga dhjetë deri në njëzet vjet.

2.Trafikimi i Narkotikëve (N.283/a) - Importimi, eksportimi, tranzitimi dhe tregtimi, në kundërshtim me ligjin, i substancave narkotike ose psikotrope, si edhe i farërave të bimëve narkotike, dënohet me burgim nga shtatë gjer në pesëmbëdhjetë vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga dhjetë gjer në njëzet vjet. Organizimi, drejtimi ose financimi i kësaj veprimtarie dënohen me burgim jo më pak se pesëmbëdhjetë vjet.

3.Kultivimi i Narkotikëve (N.284) - Kultivimi i bimëve, që shërbejnë ose dihet se shërbejnë për prodhimin dhe nxjerrjen e lëndëve narkotike dhe psikotrope, pa leje dhe autorizim sipas ligjit, dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se një herë, dënohet me burgim nga pesë gjer në dhjetë vjet. Organizimi, drejtimi apo financimi i kësaj veprimtarie, dënohen me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

4.Prodhimi, tregtimi dhe përdorimi i paligjshëm i prekursorëve (N.284/ç) - Prodhimi, importimi, eksportimi, tranzitimi, tregtimi dhe mbajtja, në kundërshtim me dispozitat përkatëse ligjore, i prekursorëve të treguar me ligj në tabelat përkatëse, dënohet me burgim gjer në pesë vjet. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim ose më shumë se njëherë, dënohet me burgim nga tre gjer në shtatë vjet. Organizimi, drejtimi ose financimi i kësaj veprimtarie dënohen me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

Analiza e veprave penale në fushën e drogave

Kodi	Kategoria	Muaji					
		Shkurt 2022	Shkurt 2023	Shkurt 2024	Shkurt 2025	Janar 2026	Shkurt 2026
D	Në Fushën e Drogave						
D1	Numri i autorëve	291	320	263	315	306	294
D2	Numri i veprave penale	240	265	188	262	262	259
D3	Prodhim dhe shitje e narkotikëve	216	240	173	251	251	250
D4	Trafikimi i narkotikëve	8	10	10	3	2	4
D5	Marijuanë e kapur (ton)	0.18	0.03	0.03	0.0	-	0.43
D6	Kokainë e kapur (kg)	1.19	2.17	1.94	4.83	2	0.5
D7	Heroinë e kapur (kg)	0.17	3.94	11.79	0.05	-	0.00

Gjetjet Kryesore



Gjatë muajit shkurt 2026, numri i autorëve të veprave penale në fushën e drogave ka shënuar 294 autorë në total ose 21 autorë më pak se muaji shkurt i vitit paraardhës, gjatë të cilit janë shënuar 315 autorë, gjithashtu në krahasim me muajin janar 2026, ka rënie 12 autorë më pak.



Gjatë muajit shkurt 2026, numri i veprave penale në fushën e drogave ka shënuar 259 raste, duke shënuar një rënie me 11 raste më pak se muaji shkurt i vitit paraardhës, ashtu sikurse krahasuar me muajin janar 2026, ka rënie me 11 raste më pak.



Kategoria "Prodhim dhe shitje narkotikësh", gjatë muajit shkurt 2026 janë shënuar 250 raste, dhe krahasuar me muajin shkurt 2025 ka rënie me 1 rast më pak, ashtu sikurse krahasuar me muajin janar 2026, ka rënie me 1 rast.



"Marijuanë e kapur", gjatë muajit shkurt 2026 janë shënuar 0.43 ton, krahasuar me muajin shkurt 2025 gjatë të cilit ka pasur 0.0 kg marijuanë e kapur, ka rënie me 0.43 ton më pak, ashtu sikurse krahasuar me muajin janar 2026.



"Kokainë e kapur", gjatë muajit shkurt 2026 janë kapur 0.5 kg ose 4.33 kg më pak krahasuar me muajin shkurt 2025, gjithashtu krahasuar me muajin janar 2026, ka rënie me 1.5 kg më pak.



"Heroinë e kapur", gjatë muajit shkurt 2026 është kapur 0.00 kg heroinë dhe krahasuar me muajin shkurt 2025 ka rënie me 0.05 kg më pak, ndërsa krahasuar me muajin janar 2026, nuk ka pësuar ndryshim.

Analiza e veprave penale në fushën e drogave

Analiza shpjeguese




Vepra penale në fushën e drogave

Vlera më e lartë e veprave penale në fushën e drogave është shënuar në muajin shkurt 2023 me 265 raste, ndërsa vlera më e ulët vihet re në shkurt 2024 me 188 raste. Gjatë muajit shkurt 2026, janë shënuar 259 vepra penale në fushën e drogave ose 16 raste më shumë se niveli mesatar i periudhës pesëvjeçare që shënon mesatarisht 243 vepra penale për muajt shkurt 2022-2026.

Në krahasim me muajin shkurt 2025, ku janë shënuar 262 të veprave penale në fushën e drogave, në shkurt 2026 ka 3 raste më pak.

Në krahasim me muajin paraardhës janar 2026, gjatë të cilit janë shënuar 262 vepra, në muajin shkurt 2026 ka rënie me 3 raste më pak.

Përgjatë periudhës janar-shkurt 2026 ka pasur 521 raste të veprave penale në fushën e drogave, ose 28 raste më pak, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.



Analiza e numrit të autorëve në fushën e drogave

Analiza shpjeguese




Numri i autorëve të veprave penale në fushën e drogave

Numri i më i lartë i autorëve në fushën e drogave është shënuar në shkurt të vitit 2023 me 320 autorë, ndërsa numri më i ulët i autorëve është shënuar gjatë muajit shkurt 2024 me 263 autorë. Gjatë muajit shkurt 2026 janë shënuar 294 autorë ose 3 autorë më pak se mesatarja e periudhës pesëvjeçare të marrë në analizë, e cila shënon 297 raste.

Në krahasim me muajin shkurt 2025, ku janë shënuar 315 autorë në muajin shkurt 2026 ka një rënie të nivelit të autorëve të veprave penale në fushën e drogave me 21 autorë më pak.

Në krahasim me muajin paraardhës janar 2026 gjatë të cilit janë shënuar 306 autorë në fushën e drogave, në muajin shkurt 2026 vihet re rënie e numrit të autorëve për veprat penale në fushën e drogave, me 12 raste më pak.

Përgjatë periudhës janar-shkurt 2026 ka pasur 600 autorë në fushën e drogave, ose 55 raste më pak, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.



Analiza e numrit të autorëve në fushën e drogave


Analiza shpjeguese

Numri i autorëve të veprave penale në fushën e drogave


Përsa i përket numrit të autorëve në fushën e drogave ndaj numrit total të autorëve të veprave penale vihet re rënie, krahasuar me raportin e veprave penale në fushën e drogave ndaj veprave penale në total. Numri i autorëve të veprave penale në fushën e drogave ka zënë peshën më të lartë si pjesë e totalit të autorëve të veprave penale në shkurt të vitit 2023 me 14.2% dhe peshën më të vogël në shkurt të 2026 me 10%. Numri i veprave penale në fushën e drogave ka zënë peshën më të lartë si pjesë e totalit të veprave penale në shkurt 2024 me 10.9% dhe peshën më të vogël në shkurt të vitit 2024 me 7.1%.

Raporti autorë për vepra penale në fushën e drogave ka luhatur në nivele krahasuar me raportin e autorëve për vepra penale në total. Numri i autorëve për veprat penale në fushën e drogave ka shënuar vlerën më të lartë në muajin shkurt të vitit 2024 me 1.40 dhe vlera më e ulët është shënuar në muajin shkurt 2026 me 1.14. Numri i autorëve për veprat penale në total ka shënuar nivelin më të lartë në muajin shkurt 2025 me 1.8 autorë dhe numrin më të vogël në muajin shkurt 2023 me 0.93 autorë.

Pesha e numrit të autorëve dhe vepra penale në fushën e drogave ndaj totaleve Shkurt 2022-2026



Raporti autorë për vepra penale në fushën e drogave dhe në total Shkurt 2022-2026



Analiza e veprës penale "Prodhim dhe shitje narkotikësh"




Analiza shpjeguese

Vepra penale në fushën e drogave "Prodhim dhe shitje narkotikësh"

Për periudhën e marrë në analizë shkurt 2022-2026, trendi i veprës "Prodhim dhe shitje e narkotikëve" ka qenë i luhatshëm. Numri më i lartë i rasteve të veprës penale 'Prodhimi dhe shitja e narkotikëve', është arritur në shkurt 2025 me 251 raste të evidentuara, ndërsa niveli më i ulët ka qenë në shkurt 2024 me 173 raste. Në krahasim me mesataren e periudhës së marrë në analizë, e cila shënon 226 vepra, gjatë muajit shkurt 2026, vihet re se është shënuar rritje me 24 vepra penale më shumë.

Gjatë muajit shkurt 2026, vihet re një rritje me 1 rast të evidentuara të veprës penale 'Prodhim dhe shitje e narkotikëve', në krahasim me muajin shkurt 2025, gjatë të cilit janë evidentuar 251 raste të tilla. Në muajin shkurt 2026 janë shënuar 250 vepra penale dhe krahasuar me muajin janar 2026 ku janë shënuar 251 vepra penale, rritje me 1 rast më shumë.

Përgjatë periudhës janar-shkurt 2026 ka pasur 501 vepra penale prodhim dhe shitje e narkotikëve, ose 27 raste më pak, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.



Analiza e veprës penale "Trafikim i narkotikëve"

Analiza shpjeguese




Vepra penale "Trafikimi i narkotikëve"

Duke krahasuar muajt shkurt për vitet 2022-2026 për kategorinë e veprave penale "Trafikimi i narkotikëve" vihet re se numri më i lartë i veprave penale është evidentuar në muajin shkurt të vitit 2023 dhe 2024 me 10 vepra penale, ndërsa numri më i ulët është shënuar në muajin shkurt të vitit 2025 me 3 raste.

Në krahasim me mesataren e periudhës shkurt 2022-2026, e cila shënon 7 raste, në shkurt 2025 janë shënuar 4 raste ose 3 raste më pak se mesatarja.

Në krahasim me muajin janar 2026 gjatë të cilit janë shënuar 8 vepra penale "Trafikim i narkotikëve", në muajin shkurt 2026 janë shënuar 4 vepra penale, ose 4 vepra penale më pak se muaji i mëparshëm.

Përgjatë periudhës janar-shkurt 2026 ka pasur 6 vepra penale "Trafikimi i narkotikëve", ose 3 raste më pak, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.



Analiza Shpjeguese

"Marijuanë e kapur"




Sasia e marijuanës së kapur ka arritur nivelin më të lartë në shkurt 2026 me 0.43 ton, ndërsa vlerën më të ulët e ka shënuar në shkurt 2023 dhe 2024 me 0.03 ton. Në shkurt 2026 vihet re rritje me 0.29 ton më shumë se mesatarja e periudhës së marrë në studim, e cila është 0.14 ton.

Gjatë muajit shkurt 2026, është shënuar 0.43 ton e marijuanës së kapur dhe krahasuar me muajin shkurt 2025, ka rritje me 0.39 ton më shumë.

Në krahasim me muajin janar 2026 gjatë të cilit është shënuar 0.00 ton, në muajin shkurt 2026 ka rritje me 0.43 ton më shumë.

Përgjatë periudhës janar-shkurt 2026 ka pasur 0.61 vepra penale "Marijuanë e kapur", ose 0.47 kg raste më pak, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Analiza e veprës penale "Marijuanë e kapur"



Analiza shpjeguese




"Kokainë e kapur"

Sasia e kokainës së kapur ka arritur nivelin më të lartë në muajin shkurt 2025 me 4.83 kg dhe niveli më i ulët është shënuar në muajin shkurt të vitit 2026 me 0.52 kg. Në shkurt 2026 janë shënuar 0.52 kg kokainë ose 1.61 kg më pak se mesatarja e periudhës së marrë në studim e cila është 2.13 kg. Në raport me muajin shkurt 2025, gjatë të cilit janë kapur 4.83 kg kokainë, në muajin shkurt 2026 evidentohet një rënie me 4.31 kg më pak e kokainës të kapur.

Në muajin shkurt 2026 është kapur një sasi prej 2.40 kg kokainë dhe krahasuar me muajin janar 2025 gjatë të cilit është kapur 0.50 kg, ka rritje me 1.9 kg më shumë e kokainës së kapur.

Përgjatë periudhës janar-shkurt 2026 ka pasur 2.90 vepra penale "Kokainë e kapur", ose 5.81 kg raste më pak, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Analiza e veprës penale "Kokainë e kapur"






Analiza Shpjeguese

"Heroinë e kapur"

Sasia e heroinës së kapur ka arritur nivelin me të lartë në muajin shkurt 2024 me 11.79 kg, ndërsa në muajin shkurt të vitit 2026 shënohet vlera më të ulët, gjatë së cilës është shënuar 0.00 kg. Në krahasim me mesataren e periudhës së marrë në shqyrtim e cila është 3.19 kg, në shkurt 2026 ka rënie me 3.19 kg.

Krahasuar me muajin shkurt 2025, janë shënuar 0.05 kg dhe në muajin shkurt 2026, ka rënie me 0.05 kg më pak. Përgjatë periudhës janar-shkurt 2026 ka pasur 0.00 vepra penale "Heroinë e kapur", ose 0.18 kg raste më pak, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Analiza e veprës penale "Heroinë e kapur"





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Veprat Penale mbi Krimin Kompjuterik

Shkurt 2026

Përmbledhje e Neneve të Veprave Penale të Krimin Kompjuterik

1. Mashtrimi kompjuterik (N.143/b) - Futja, ndryshimi, fshirja ose heqja e të dhënave kompjuterike apo ndërhyrja në funksionimin e një sistemi kompjuterik, me qëllim për t'i siguruar vetes apo të tretëve, me mashtrim, një përfitim ekonomik të padrejtë apo për t'i shkaktuar një të treti pakësimin e pasurisë, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në gjashtë vjet dhe me gjobë nga 60 000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë deri në 600 000 (gjashtëqind mijë) lekë. Po kjo vepër, kur kryhet në bashkëpunim, në dëm të disa personave, më shumë se një herë ose kur ka sjellë pasoja të rënda materiale, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet dhe me gjobë nga 500 000 (pesëqind mijë) lekë deri në 5 000 000 (pesë milionë) lekë.

2. Hyrja e paautorizuar kompjuterike (N.192/b)- Hyrja e paautorizuar apo në tejkalim të autorizimit për të hyrë në një sistem kompjuterik a në një pjesë të tij, nëpërmjet cenimit të masave të sigurimit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre vjet. Kur kjo vepër kryhet në sistemet kompjuterike ushtarake, të sigurisë kombëtare, të rendit publik, të mbrojtjes civile, të shëndetësisë apo në çdo sistem tjetër kompjuterik, me rëndësi publike, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet.

3. Përgjimi i paligjshëm i të dhënave kompjuterike (N.293/a) - Përgjimi i paligjshëm me mjete teknike i transmetimeve jopublike, i të dhënave kompjuterike nga/ose brenda një sistemi kompjuterik, përfshirë emetimet elektromagnetike nga një sistem kompjuterik, që mbart të dhëna të tilla kompjuterike, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet. Kur kjo vepër kryhet nga/ose brenda sistemeve kompjuterike ushtarake, të sigurisë kombëtare, të rendit publik, të mbrojtjes civile apo në çdo sistem tjetër kompjuterik, me rëndësi publike, dënohet me burgim nga shtatë deri në pesëmbëdhjetë vjet.

4. Ndërhyrja në të dhënat kompjuterike (N.293/b) - Dëmtimi, shtrembërimi, ndryshimi, fshirja apo suprimimi i paautorizuar i të dhënave kompjuterike dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në tre vjet. Kur kjo vepër kryhet në të dhënat kompjuterike ushtarake, të sigurisë kombëtare, të rendit publik, të mbrojtjes civile, të shëndetësisë apo në çdo të dhënë tjetër kompjuterike, me rëndësi publike, dënohet me burgim nga tre deri në dhjetë vjet. Në rastet kur veprimet e parashikuara në paragrafin e parë janë kryer nga një i mitur, ndaj tij do të zbatohen dispozitat e Kodit të Drejtësisë për të Mitur.

5. (N.293/c) - Krijimi i pengesave serioze dhe të paautorizuara për të cenuar funksionimin e një sistemi kompjuterik, nëpërmjet futjes, dëmtimit, shtrembërimit, ndryshimit, fshirjes apo suprimimit të të dhënave, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet. Kur kjo vepër kryhet në sistemet kompjuterike ushtarake, të sigurisë kombëtare, të rendit publik, të mbrojtjes civile, të shëndetësisë apo në çdo sistem tjetër kompjuterik, me rëndësi publike, dënohet me burgim nga pesë deri në pesëmbëdhjetë vjet. Në rastet kur veprimet e parashikuara në paragrafin e parë janë kryer nga një i mitur, ndaj tij do të zbatohen dispozitat e Kodit të Drejtësisë për të Mitur.

6. Keqpërdorimi i pajisjeve (N.293/ç) - Prodhimi, mbajtja, shitja, dhënia në përdorim, shpërndarja apo çdo veprim tjetër, për vënien në dispozicion të një pajisjeje, ku përfshihen edhe një program kompjuterik, një fjalëkalim kompjuterik, një kod hyrjeje apo një e dhënë e tillë e ngjashme, të cilat janë krijuar ose përshtatur për hyrjen në një sistem kompjuterik ose në një pjesë të tij, me qëllim kryerjen e veprave penale, të parashikuara në nenet 192/b, 293/a, 293/b e 293/c të këtij Kodi, dënohen me burgim nga gjashtë muaj deri në pesë vjet.

Analiza e Veprave Penale të Krimit Kompjuterik

Kategoria	Muaji					
	Shkurt 2022	Shkurt 2023	Shkurt 2024	Shkurt 2025	janar 2026	Shkurt 2026
Krimi Kompjuterik (N.143/b, 192/b, 293/a/b/c/ç)	44	44	144	93	81	101
Vepra penale në fushën e Teknologjisë së Informacionit (Nr)	23	21	119	76	70	81
Vepra penale të kryera nëpërmjet sistemit kompjuterik	21	23	25	17	11	20

Gjetjet Kryesore



Gjatë muajit shkurt 2026, numri i veprave penale të "Krimin Kompjuterik" ka shënuar në total 101 vepra dhe krahasuar me muajin shkurt 2025, gjatë të cilit janë shënuar 93 vepra penale, ka rritje me 8 vepra, gjithashtu krahasuar me muajin janar 2026 ka rritje me 20 vepra penale më shumë.



Veprat penale në fushën e teknologjisë së informacionit, gjatë muajit shkurt 2026, kanë shënuar 81 vepra ose 5 më shumë krahasuar me muajin shkurt 2025, gjatë të cilit janë shënuar 76 vepra, gjithashtu krahasuar me muajin janar 2026, ka rritje me 11 vepra më shumë.



Veprat penale të kryera nëpërmjet sistemit kompjuterik, gjatë muajit shkurt 2026 kanë shënuar 20 vepra dhe krahasuar me muajin shkurt 2025 ka pësuar rritje me 3 vepra penale, gjithashtu krahasuar me muajin janar 2026, gjatë të cilit janë shënuar 11 vepra penale, ka rritje me 9 vepra më shumë.

Analiza Shpjeguese



Krimi Kompjuterik (N.143/b, 192/b, 293/a/b/c/ç)

Gjatë periudhës pesëvjeçare shkurt 2022 - shkurt 2026 rastet e krimit kompjuterik kanë patur trend të luhatshëm dhe në muajin shkurt 2024 shënuar vlera më e lartë me 144 raste të evidentuara, ndërsa niveli më i ulët është shënuar në muajin shkurt 2022 dhe 2023, me 44 raste të evidentuara.

Në shkurt të vitit 2026, janë evidentuar 101 raste dhe krahasuar me mesataren e e periudhës pesëvjeçare shkurt 2022-2026, e cila shënon 85 raste, ka rritje me 16 raste më shumë.

Në krahasim me muajin shkurt 2025 ku janë evidentuar 93 raste të krimeve kompjuterike, muaji shkurt 2026 ka rritje me 8 raste ose 9% më shumë. Në krahasim me muajin janar 2026, ku janë evidentuar në 81 krime kompjuterike, në muajin shkurt 2026 janë shënuar 20 raste ose 25% më shumë, vepra penale me krimeve kompjuterike.

Analiza e Krimeve Kompjuterike





Analiza e Krimeve Kompjuterike

Analiza Shpjeguese

Krimi Kompjuterik (N.143/b, 192/b, 293/a/b/c/ç62)

Në muajin shkurt 2026 janë shënuar 182 raste, vihet re një rritje me 27 raste 17.4% më shumë e krimeve kompjuterike, se në muajin shkurt 2025, ku janë shënuar 155 raste.

Në lidhje me kategoritë e krimit kompjuterik vihet re se përqindja më e lartë shënohet në muajin shkurt 2026 me 80.2% në fushën e veprave penale të Teknologjisë dhe Informacionit, ndërsa pesha më e ulët në fushën e veprave penale nëpërmjet sistemit kompjuterik shënohet në muajin shkurt 2026 me 19.8%.



Analiza e Veprës Penale "Vepra penale në fushën e Teknologjisë së Informacionit" (Nr)

Analiza Shpjeguese

Vepra penale në fushën e Teknologjisë së Informacionit (Nr)




"Vepra penale në fushën e Teknologjisë së Informacionit" për periudhën e muajit shkurt 2022-2026, ka shënuar numrin më të lartë në muajin shkurt të vitit 2024 me 119 raste dhe numrin më të ulët në shkurt 2023 me 21 raste.

Për muajin shkurt 2026 janë shënuar 17 raste më shumë se niveli mesatar i periudhës shkurt 2021-2026, që shënon mesatarisht 64 raste.

Krahasuar me muajin shkurt 2025, ku janë 76 vepra penale, në shkurt 2026 ka rritje me 5 vepra më shumë.

Krahasuar me muajin janar 2026, ku janë evidentuar 70 vepra penale të kësaj kategorie, në shkurt 2026 ka rritje me 11 raste më shumë. Në muajin shkurt 2026 janë shënuar 81 vepra penale ose 7% më shumë vepra penale në fushën e Teknologjisë së Informacionit, në raport krahasimor me muajin shkurt 2025, ku janë shënuar 76 vepra penale.

Përgjatë periudhës janar-shkurt 2026 janë shënuar 151 raste vepra penale në fushën e Teknologjisë dhe informacionit, ose 24 % më shumë, se në të njëjtën periudhë janar-shkurt 2025, gjatë të cilës ka pasur 122 raste.



Analiza Mujore e "Veprave penale të kryera nëpërmjet sistemit kompjuterik"




Analiza Shpjeguese

Vepra penale të kryera nëpërmjet sistemit kompjuterik

Veprat penale të kryera nëpërmjet sistemit kompjuterik në periudhën shkurt 2022-2026, kanë arritur nivelin më të lartë në muajin shkurt vitit 2024 me 25 raste, ndërkohë vlera më e ulët vihet re në shkurt të 2025 me 17 raste.

Krahasuar me mesataren e periudhës shkurt 2022-2026, e cila shënon 21 raste, gjatë muajit shkurt të vitit 2026 ka pësuar rënie me 1 rast më pak. Për muajin shkurt 2026 veprat penale të kryera nëpërmjet sistemit kompjuterik janë 20 raste dhe krahasuar me muajin shkurt 2025, ka rritje me 3 raste më shumë. Krahasuar me një muaj më parë, gjatë të cilit ka pasur 11 raste, në muajin shkurt 2026 ka rritje me 9 raste.

Përgjatë periudhës janar-shkurt 2026 janë shënuar 31 raste vepra penale në fushën e Teknologjisë dhe informacionit, ose 6% më pak, se në të njëjtën periudhë janar-shkurt 2025, gjatë të cilës ka pasur 33 raste.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Veprat Penale Kundër Mjedisit

Shkurt 2026

Përmbledhje e Neneve të Veprave Penale të Krimin Mjedisor

1.Ndërtimi i paligjshëm(N.199/a)-Ndërtimi i kryer pa leje, në shkelje të rëndë të lejes ose në kushtet e një lejeje të shfuqizuar në tokën në pronësi të vet, dënohet me burgim deri në një vit. Po kjo vepër, e kryer në tokën publike ose shtetërore apo në tokën e tjetrit, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. Po kjo vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda apo e kryer për qëllime fitimi, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.

2.Dhënia e ndihmës për ndërtim të paligjshëm(N.199/b)- Cilido që ofron dhe kryen shërbime sipërmarrjeje, mbikëqyrjeje, zbatim punimesh në një ndërtim të paligjshëm, dënohet me burgim deri në 3 vjet.

3.Prerja e Paligjshme e Pyjeve(N.205)-Prerja apo dëmtimi i pyjeve pa leje apo në kohë dhe vende të ndaluara, kur vepra nuk përbën kundërvajtje administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.

Analiza e Veprave Penale të Krimit Mjedisor

Kodi	Kategoria	Muaji					
		Shkurt 2022	Shkurt 2023	Shkurt 2024	Shkurt 2025	Shkurt 2026	Janar 2026
	Krimi Mjedisor	154	113	111	125	108	112
F_1	Ndërtim i paligjshëm (N.199/a/b)	137	96	102	108	97	102
F_2	Prerja e paligjshme e pyjeve (N. 205)	17	17	9	17	11	10

Gjetjet Kryesore



Gjatë muajit shkurt 2026, numri i veprave penale të krimit mjedisor ka shënuar rënie me 17 raste më pak krahasuar me muajin shkurt 2025, ku janë shënuar 125 raste, gjithashtu, krahasuar me muajin paraardhës janar 2026 vihet re rënie 4 raste.



Vepra penale "Ndërtim i Paligjshëm" gjatë muajit shkurt 2026 ka shënuar 97 raste në total, duke shënuar rënie me 11 raste më pak në krahasim me muajin shkurt të vitit të kaluar, gjatë të cilit janë shënuar 108 raste.



Vepra penale "Prerja e paligjshme e pyjeve", gjatë muajit shkurt 2026 janë shënuar 11 vepra penale, në krahasim me muajin shkurt 2025 ku janë shënuar 17 raste, vihet re rënie me 6 raste, ndërsa, në krahasim me muajin janar 2025, ku janë shënuar 11 raste, vihet re rënie me 1 rast.

Analiza e Krimeve Mjedisor

Analiza Shpjeguese



Krimi Mjedisor

Gjatë periudhës shkurt 2022-2026, krimi mjedisor ka shënuar vlerën më të lartë në muajin shkurt të vitit 2022 me 154 raste të evidentuara, ndërsa niveli më i ulët i krimeve mjedisore është shënuar në muajt shkurt të vitit 2026 me 108 raste.

Në shkurt të vitit 2026, janë evidentuar në total 108 raste të krimit mjedisor dhe krahasuar me mesataren e periudhës së analizuar, e cila shënon mesatarisht 122 raste për muajt e marrë në analizë, shënohet rënie me 14 raste.

Në muajin shkurt 2026, janë evidentuar 108 raste të krimeve mjedisore në total, krahasuar me muajin shkurt 2025 shënon një rënie me 17 raste.

Në krahasim me muajin janar 2026 ku janë evidentuar 112 raste të krimit mjedisor, në muajin shkurt 2026, vihet re rënie me 4 raste.





Analiza Shpjeguese

Krime Mjedisore

Duke iu referuar të dhënave kumulative, vihet re një rënie me 5% ose 11 raste më pak të krimeve mjedisore në janar-shkurt 2026 ku, janë shënuar 220 raste, në krahasim me periudhën homologe të vitit paraardhës, ku janë shënuar në total 231 raste.

Përsa i përket kategorive të krimeve mjedisore, pjesën më të madhe e zënë "Ndërtimet e Paligjshme", në krahasim me "Prerjen e paligjshme të pyjeve". Pesha më e lartë e kësaj kategorie të krimit mjedisor është shënuar në shkurt të vitit 2024 me 91.9%, kurse pesha më e ulët që zë kjo kategori e krimit mjedisor është në shkurt 2023 me 85%. Vepra penale "Prerja e Paligjshme e Pyjeve", ka shënuar vlerën më të madhe në muajin shkurt 2023 me 15% të totalit të krimeve mjedisore kurse pesha më e ulët që zë kjo kategori e krimit mjedisor është në shkurt 2024 me 801%. Gjatë muajit shkurt 2026 "Ndërtimet e Paligjshme", kanë zënë një peshë prej 90% dhe "Prerja e Paligjshme e pyjeve", ka shënuar 10%.

Analiza e Krimeve Mjedisore



Analiza e Veprës Penale "Ndërtim i Paligjshëm"

Analiza Shpjeguese




Ndërtimi i Paligjshëm (N.199/a/b)

Ecuria e veprës penale "Ndërtimi i Paligjshëm (N.199/a/b)" për muajin shkurt në vitet 2022-2026, shënon numrin më të lartë në shkurt 2022 me 137 raste dhe numrin më të ulët e ka shënuar në shkurt të vitit 2023 me 96 raste.

Në muajin shkurt 2026, janë shënuar 97 raste të kësaj kategorie ose 11 raste më pak se niveli mesatar i periudhës së marrë në analizë, e cila ka shënuar në total 108 raste. Në krahasim me muajin shkurt 2025, ku janë evidentuar 108 raste të krimeve mjedisore në total, muaji shkurt 2026 shënoi një rënie me 11 të këtyre rasteve.

Në muajin janar 2026, janë evidentuar 102 raste të kësaj kategorie, ndërsa në muajin shkurt 2026 janë shënuar 97 raste, evidentohet një rënie me 5 vepra penale.

Përsa i përket të dhënave kumulative, për periudhën janar-shkurt 2026, gjatë të cilit janë shënuar 199 raste, evidentohet një rënie me 3.9% ose 8 raste më pak në krahasim me periudhën homologe të vitit paraardhës, ku janë shënuar 207 raste.



Analiza Mujore e veprës penale "Prerja e Paligjshme e Pyjeve"

Analiza Shpjeguese

Prerja e Paligjshme e Pyjeve (N.205)




Prerja e paligjshme e pyjeve në periudhën shkurt 2022- shkurt 2026 ka arritur nivelin më të lartë në muajt shkurt të viteve 2022, 2023 dhe 2025 me 17 të tilla dhe nivelin më të ulët në shkurt të vitit 2024 me 9 raste.

Krahasuar me mesataren e periudhës pesëvjeçare të marrë në analizë, në shkurt 2026, vihet re se niveli i krimeve mjedisore "Prerja e Paligjshme e Pyjeve", ka rezultuar me 3 raste më pak se mesatarja e pesëvjeçarit, e cila shënon mesatarisht 14 raste të evidentuara.

Për muajin shkurt 2026 prerjet e paligjshme, kanë shënuar rënie me 6 raste, krahasuar me muajin shkurt 2025, gjatë të cilit janë shënuar në total 17 raste.

Duke iu referuar krahasimit të muajit janar 2026 me muajin pasardhës shkurt 2026, vihet re rritje me 1 rast i veprave penale "Prerja e Paligjshme e pyjeve".

Të dhënat kumulative tregojnë se vlera e numrit të prerjeve të paligjshme në janar-shkurt 2026, në krahasim me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar shënohet një rënie me 12.5% ose 3 raste më pak.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Analiza Mujore e Veprave Penale në Fushën e Qarkullimit Rrugor

Shkurt 2026

Përmbledhje e neneve të veprave penale në Fushën e Qarkullimit Rrugor

- 1. Largimi nga vendi i aksidentit(N.273)**-Largimi nga vendi i aksidentit, i drejtuesit të automjetit apo të çdo mjeti të motorizuar, për t'u shmangur nga përgjegjësia penale, civile apo administrative, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit.
- 2. Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor(N.290)**-Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, kur ka shkaktuar plagosjen e lehtë të disa personave, dënohet me gjobë ose me burgim deri në një vit. Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, kur ka shkaktuar plagosjen e rëndë të një personi, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet. Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor, kur ka shkaktuar vdekjen e një personi, dënohet me burgim nga dy deri në dhjetë vjet. Kur nga vepra penale është shkaktuar vdekja ose plagosja e rëndë e disa personave, dënohet me burgim nga pesë deri në njëzet vjet.
- 3. Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt(N.291)**-Drejtimi i automjeteve apo mjeteve të tjera të motorizuara në gjendje të dehur, nën efektin e lëndëve narkotike apo pa dëshminë përkatëse të aftësisë dënohet me burgim nga dhjetë ditë deri në tre vjet. Gjykata mund të vendosë zëvendësimin e dënimit me burgim me pagimin e një shume të hollash në favor të shtetit.

Analiza e veprave penale në fushën e qarkullimit rrugor

Kodi	Kategoria	Muaji					
		Shkurt 2022	Shkurt 2023	Shkurt 2024	Shkurt 2025	Shkurt 2026	Janar 2026
G	Vepra penale në fushën e qarkullimit rrugor						
G1	Aksidente	77	88	108	88	97	96
G2	Drejtim i automjeteve në mënyrë të parregullt	336	230	237	306	296	245
G3	Largim nga vendi i aksidentit	32	25	32	30	28	35
G4	Të vrarë në aksidente (Nr i Viktimave)	16	14	8	19	12	22
G5	Të plagosur rëndë në aksidente (Nr i individëve)	12	6	14	21	9	13
G6	Masat administrative nga Policia Rrugore (gjobat)	58,061	61,506	88,488	84,862	106,993	106,685

Gjetjet Kryesore



Gjatë muajit shkurt 2026 janë evidentuar 97 aksidente rrugore dhe krahasuar me muajin shkurt 2025, ka rritje me 1 aksidente më shumë, gjithashtu krahasuar me muajin janar 2026, gjatë të cilit ka pasur 88 raste ka rritje me 9 raste më shumë.



Numri i individëve të vrarë në aksidente, për muajin shkurt 2026 është 12 viktima dhe krahasuar me muajin shkurt 2025, ka rënie me 7 viktima, gjithashtu në raport me muajin janar 2026, ka rënie me 10 viktima më pak.



Numri i individëve të plagosur rëndë në aksidente për muajin shkurt 2026 ka shënuar 9 të plagosur rëndë dhe krahasuar me muajin shkurt 2025, ka rënie me 11 raste më pak, gjithashtu krahasuar me muajin janar 2026, ka rënie me 4 raste me pak.





Masat administrative nga Policia Rrugore (gjobat) kanë shënuar 106,993 për muajin shkurt ose 26% më shumë se numri i gjobave të shënuara gjatë muajit shkurt 2025, gjithashtu në raport me muajin janar 2026 ka rritje me 0.3% më shumë.

Analiza e Shkeljeve të rregullave të qarkullimit rrugor (Aksidente)

Analiza Shpjeguese

Aksidente

Për periudhën 5-vjeçare shkurt 2022-2026, numri më i lartë i aksidenteve është shënuar në muajin shkurt 2024 me 108 raste dhe numri më i ulët në muajin shkurt 2022 me 77 raste. Krahasuar me muajin shkurt 2025 gjatë të cilit janë shënuar 88 raste, në muajin shkurt 2026 janë shënuar 97 aksidente dhe ka rënie me 11 raste më shumë. Mesatarja e muajve shënon 92 aksidente dhe në muajin shkurt 2026, ka rritje me 5 aksidente më shumë. Në muajin janar 2026 janë shënuar 96 raste të veprës penale "Aksidente" dhe në muajin shkurt 2026, ka rritje me 1 rast më shumë.




Analiza e Shkeljeve të rregullave të qarkullimit rrugor (Aksidente)

Analiza Shpjeguese


Aksidente

Në periudhën janar-shkurt 2026 janë shënuar 193 aksidente ose 9.4% më pak krahasuar me periudhën janar-shkurt 2025. Niveli më i lartë i numrit të viktimave në raport me numrin e aksidenteve për periudhën shkurt 2022-2026 shënohet në muajin shkurt 2025 me 23.9% dhe niveli më i ulët shënohet në muajin shkurt 2024 me 7.4%. Niveli më i lartë i numrit të të plagosurve shënohet në muajin shkurt 2025 me 23.9% dhe niveli më i ulët shënohet në muajin shkurt 2023 me 6.8%.

Vepra penale "Aksidente" Janar-Shkurt 2025 & Janar-Shkurt 2026



Vepra penale 'Aksidentet- sipas kategorive' në % Shkurt 2022-2026



"Persona të vrarë në aksidente"




Analiza Shpjeguese

"Persona të vrarë në aksidente"

Përgjatë periudhës 5-vjeçare numri më i lartë i persona të vrarë në aksidente ka qenë në muajin shkurt 2025 me 19 viktima dhe numri më i ulët në muajin shkurt 2024 me 8 viktima. Në muajin shkurt të vitit 2026, janë shënuar 12 persona të vrarë në aksidente dhe krahasuar me mesataren e pesë viteve për muajin shkurt, ku shënohen 14 persona të vrarë në aksidente, ka rënie me 2 viktima më pak.

Në muajin janar 2026 janë shënuar 22 persona të vrarë në aksidente dhe në muajin shkurt 2026 janë 12 viktima të vrarë në aksidente, ose 10 viktima më pak. Në muajin shkurt 2026 janë shënuar 22 viktima dhe krahasuar me muajin janar 2026, ka rritje me 4 viktima më shumë.

Përgjatë periudhës janar-shkurt 2026 janë shënuar 34 viktima ose 2 viktima më shumë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, gjatë të cilit ka pasur 32 viktima.



"Persona të plagosur në aksidente"

Analiza Shpjeguese


"Persona të plagosur në aksidente"

Gjatë periudhës shkurt 2022-2026 numri më i lartë i të plagosurve rëndë në aksidente ka qenë në muajin shkurt të vitit 2025 me 21 persona të plagosur rëndë. Numri më i ulët është shënuar në muajin shkurt të vitit 2023 me 6 persona të plagosur rëndë. Në raport me mesataren e pesë viteve të marra në studim, e cila shënon 9 persona, në muajin shkurt 2026, ka rënie me 3 raste më pak. Krahasuar me muajin shkurt 2025 gjatë të cilit janë shënuar 21 të plagosur rëndë, në muajin shkurt 2026, ka rënie me 11 të plagosur më pak.


Në muajin janar 2026, numri i individëve të plagosur rëndë shënohet 13 persona dhe krahasuar me muajin shkurt 2026, ka rënie me 4 persona më pak.

Përgjatë periudhës janar-shkurt 2026 janë shënuar 22 të plagosur ose 12 të plagosur më pak, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, gjatë të cilit ka pasur 34 persona.


"Persona të plagosur në aksidente" (Nr),
Shkurt 2022-2026



"Persona të plagosur në aksidente"
Janar 2026 - Shkurt 2026



"Persona të plagosur në aksidente"
Janar-Shkurt 2025 & Janar - Shkurt 2026



Analiza në Vepra Penale "Drejtimi i Automjeteve në mënyrë të parregullt"

Analiza Shpjeguese


Vepra Penale "Drejtimi i Automjeteve në mënyrë të parregullt"

Përgjatë periudhës shkurt 2022-2026, numri i veprave penale të drejtimit të automjeteve në mënyrë të parregullt ka arritur nivelin më të lartë në muajin shkurt 2022 me 336 raste të drejtimit të automjeteve dhe nivelin më të ulët në muajin shkurt 2023 me 230 raste. Krahasuar me mesataren e periudhës së analizuar, e cila shënon 281 raste të evidentuara, gjatë muajit shkurt 2026 niveli i evidentuar ka shënuar rënie me 15 vepra penale. Krahasuar me muajin shkurt 2025 ka rënie me 10 rast më pak.


Në muajin shkurt 2026 numri i veprave penale "Drejtimi i Automjeteve në mënyrë të parregullt" ka shënuar rritje me 51 vepra ose 20.8% më shumë, në raport me muajin paraardhës.

Përgjatë periudhës janar-shkurt 2026 janë shënuar 541 vepra ose 9 vepra më pak, krahasuar me të njejtën periudhë të një viti më parë, gjatë të cilit ka pasur 550 viktima.


Vepra Penale "Drejtimi i Automjeteve në mënyrë të parregullt" (Nr) Shkurt 2022-2026



Vepra Penale "Drejtimi i Automjeteve në mënyrë të parregullt" Janar 2026 - Shkurt 2026



Vepra penale 'Drejtimi i Automjeteve në mënyrë të parregullt' Janar-Shkurt 2025 & Janar-Shkurt 2026



Analiza në Vepra Penale "Largim nga vendi i aksidentit"




Analiza Shpjeguese

Vepra Penale "Largim nga vendi i aksidentit"

Gjatë periudhës shkurt 2022-2026, vihet re se, numri më i lartë i veprës penale "Largim nga vendi i aksidentit", shënohet në muajin shkurt të vitit 2022 dhe 2024 me 32 raste të shënuara, ndërsa niveli më i ulët është evidentuar në muajin shkurt të vitit 2023 me 25 raste të evidentuara.

Krahasuar me mesataren e periudhës së analizuar, e cila shënon mesatarisht 29 raste të evidentuara në muaj, gjatë muajit shkurt 2026, ka rritje me 5 raste më shumë. Në muajin shkurt 2026 janë shënuar 28 vepra penale ose 2 vepra më pak, krahasuar me muajin shkurt 2026. Në muajin janar 2026 janë shënuar 35 raste dhe në muajin shkurt 2026 ka rënie me 7 raste.

Përgjatë periudhës janar-shkurt 2026 janë shënuar 63 vepra ose 6 vepra më shumë, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, gjatë të cilit ka pasur 57 vepra.



Analiza mbi Masat Administrative nga Policia e Rrugore

Analiza Shpjeguese




Vepra Penale "Masat Administrative nga Policia Rrugore (gjobat)"

Përgjatë periudhës shkurt të viteve 2022-2026, numri i masave administrative nga policia rrugore (gjobave) ka arritur nivelin më të lartë në muajin shkurt 2026 me 106,993 masa administrative dhe nivelin më të ulët në muajin shkurt 2022 me 58,061 masa administrative.

Në shkurt 2026 numri i rasteve mbi "Masat administrative nga Policia Rrugore" është 26% më shumë se një vit më parë.

Në krahasim me muajin janar 2026, ku janë shënuar 106,685 masa administrative, gjatë muajit shkurt 2026 numri i masave administrative shënoi rritje me 0.3%.

Përgjatë periudhës janar-shkurt 2026 janë shënuar 213,678 vepra ose 47,320 vepra më shumë, krahasuar me të njejtën periudhë të një viti më parë, gjatë të cilit ka pasur 166,358 vepra.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Analiza Mujore e Bashkëpunimit Ndërkombëtar

Shkurt 2026

Analiza Mujore e Bashkëpunimit Ndërkombëtar për Menaxhimin e Kufijve

Kodi	Kategoria	Shkurt 2022					
		Shkurt 2022	Shkurt 2023	Shkurt 2024	Shkurt 2025	Shkurt 2026	Janar 2026
	Menaxhimi i Kufijve						
H1	Në kërkim kombëtar	150	129	167	183	150	141
H2	Në kërkim ndërkombëtar	5	9	23	26	10	11

Gjetjet Kryesore



Gjatë muajit shkurt 2026 kanë rezultuar 150 persona në kërkim kombëtar, duke shënuar rënie me 33 më pak, të personave të kërkuar krahasuar me muajin shkurt 2025, gjithashtu krahasuar me muajin janar 2026, numri i personave në kërkim kombëtar ka shënuar rritje me 9 raste më shumë.



Gjatë muajit shkurt 2026, janë 10 persona në kërkim ndërkombëtar dhe krahasuar me muajin shkurt 2025, ka rënie me 16 raste më pak, gjithashtu krahasuar me muajin janar 2026, ka pasur rënie me 1 person të kapur më pak.

Analiza e veprës penale 'Persona në Kërkim Kombëtar'




Analiza Shpjeguese

Persona në kërkim kombëtar

Për periudhën pesë vjeçare shkurt 2022- 2026, numri i personave në kërkim kombëtar ka arritur nivelin më të lartë në muajin shkurt të vitit 2025 me 183 raste të personave në kërkim kombëtar, ndërsa niveli më i ulët është shënuar në muajin shkurt të vitit 2023 me 129 persona. Në muajin shkurt 2026 janë shënuar 150 persona në kërkim kombëtar dhe krahasuar me nivelin e mesatares së pesë viteve, ka rënie me 6 raste më pak. Krahasuar me muajin shkurt të një viti më parë, numri i personave në kërkim kombëtar ka shënuar rënie me 18% më pak.

Në krahasim me muajin janar 2026, ku janë shënuar 141 persona në kërkim kombëtar, gjatë muajit shkurt 2026 ka pësuar rritje me 6% ose 9 persona më shumë.

Përgjatë periudhës janar-shkurt 2026 janë kapur 291 persona në kërkim kombëtar dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ka rënie me 12% ose 39 persona më pak.






Analiza e veprës penale 'Persona Ndërkombëtar'

Analiza Shpjeguese

Persona në Kërkim Ndërkombëtar

Për periudhën shkurt 2022-2026, numri i personave në kërkim ndërkombëtar ka arritur nivelin më të lartë në muajin shkurt të vitit 2025 me 26 persona, ndërsa niveli më i ulët është shënuar në muajin shkurt 2022 me 5 persona në kërkim ndërkombëtar. Në muajin shkurt 2026 janë shënuar 10 persona dhe krahasuar me mesataren e pesë viteve të përfshira në studim, e cila shënon 15 persona në kërkim ndërkombëtar, ka rënie me 5 persona të kapur më pak. Në raport me muajin shkurt 2025 gjatë të cilit ka pasur 26 persona në kërkim, në muajin shkurt 2026, ka rënie me 16 persona më pak. Në muajin janar 2026 ka pasur 11 persona në kërkim ndërkombëtar dhe në muajin shkurt 2026, ka rënie me 1 person më pak.

Përgjatë periudhës janar-shkurt 2026 janë kapur 21 persona në kërkim kombëtar dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ka rënie me 54.3% ose 25 persona më pak.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Analiza Mujore e Menaxhimit të Kufijve Shkurt 2025

Analiza e Menaxhimit të Kufijve

Kodi	Kategoria	Muaji					
		Shkurt 2022	Shkurt 2023	Shkurt 2024	Shkurt 2025	Janar 2026	Shkurt 2026
	Menaxhimi I Kufijve						
M1	Hyrje qytetarë të huaj	200,997	309,325	480,539	516,058	583,799	516,231
M2	Turistë të huaj	28,349	120,298	205,320	200,887	194,932	183,671
M3	Emigrantë të huaj të parregullt të kapur në vend	297	294	65	89	81	269
M4	Azilkërkues shqiptarë në BE	720	635	565	355	0	na
M5	Kthimet (vullnetare+azilkërkues të refuzuar, forcërisht)	453	548	742	671	569	483

Gjetjet Kryesore



Gjatë muajit shkurt 2026 në Shqipëri kanë hyrë 516,231 qytetarë të huaj dhe ka shënuar rritje me 173 qytetarë të huaj më shumë, se në muajin shkurt 2025, ndërsa krahasuar me muajin janar 2026 ka rënie me 67,568 hyrje qytetarësh të huaj më pak.



Numri i turistëve të huaj të ardhur në Shqipëri gjatë muajit shkurt 2026 ka qenë 183,671 persona dhe në të njëjtin muaj të vitit të kaluar ky numër ka shënuar 17,216 turistë më pak, gjithashtu krahasuar me muajin janar 2026 ka rënie me 11,261 turistë më pak.



Gjatë muajit shkurt 2026 janë 269 emigrantë të huaj të parregullt të kapur në vend, duke shënuar rritje me 180 më shumë, krahasuar me muajin shkurt 2025, gjithashtu në raport me muajin paraardhës ka rritje me 188 emigrantë të huaj më shumë.



Kthime (vullnetare+azilkërkues të refuzuar, forcërisht) në muajin shkurt 2026 janë shënuar 483 kthime shtetasish dhe krahasuar me muajin shkurt 2025 ka pasur rënie me 188 më pak, gjithashtu krahasuar me muajin janar 2026 ka rënie me 86 kthime shtetasish më pak.

Analiza e Numrit të 'Hyrje Qytetarë të Huaj'




Analiza Shpjeguese

Hyrje qytetarë të huaj

Numri i hyrjeve të qytetarëve të huaj gjatë periudhës së marrë në analizë për vitet 2022-2026, ka pasur trend në rritje. Niveli më i ulët i hyrjeve të qytetarëve të huaj është shënuar në shkurt 2022 me 200,997 qytetarë të huaj, ndërsa niveli më i lartë është shënuar në shkurt 2026 me 516,231 qytetarë të huaj që kanë hyrë në RSH-së. Krahasuar me mesataren e muajve shkurt për periudhën pesë vjeçare, e cila shënon 404,630 qytetarë të huaj në muajin shkurt 2026, vihet re një rritje me 111,601 hyrje e qytetarëve të huaj. Krahasuar me muajin shkurt 2025, ku janë shënuar 516,058 qytetarë, muaji shkurt i vitit 2026 ka shënuar rritje me 173 hyrje qytetarësh më shumë.

Krahasuar me muajin janar 2026 ku janë shënuar 583,799 qytetarë, muaji shkurt i vitit 2026 ka shënuar rënie me 12% më pak.

Përgjatë periudhës janar-shkurt 2026 janë shënuar 1,100,030 hyrje të qytetarëve të huaj dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë ka rritje me 2% më shumë.






Analiza e Numrit të 'Turistëve të Huaj'

Analiza shpjeguese

Turistë të huaj

Për periudhën shkurt 2022-2026, vihet re se trendi i numrit të turistëve të huaj ka qenë në rritje. Niveli më i ulët është shënuar në shkurt 2022 me 28,349 turistë dhe niveli më i lartë është shënuar në muajin shkurt 2024 me 205,320 turistë. Në muajin shkurt 2025, numri i turistëve ka shënuar 17,216 turistë më pak, krahasuar me muajin shkurt 2025. Mesatarja për periudhën shkurt 2022-2026 shënon 147,705 turistë të huaj në RSH dhe muaji shkurt 2026 krahasuar me mesataren, ka shënuar rritje me 35,966 turistë më shumë. Në raport krahasimor me një muaj më parë situata e turistëve të huaj ka shënuar rënie me 11,261 ose 6% më pak turistë të huaj.

Përgjatë periudhës janar-shkurt 2026 janë shënuar 378,603 turistë të huaj dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë ka rënie me 13% më pak.



Analiza e Numrit të 'Emigrantëve të huaj të parregull të kapur në vend'




Analiza Shpjeguese

Emigrantë të huaj të parregull të kapur në vend

Gjatë periudhës shkurt 2022- 2026, numri mesatar i emigrantëve të huaj të parregull të kapur në vend është 203 shtetas. Niveli më i lartë është evidentuar në shkurt 2022 me 297 të tillë, ndërsa niveli më i ulët ka qenë në shkurt 2024 me 65 emigrantë të huaj të parregull të kapur në vend. Në muajin shkurt 2026 janë shënuar 66 raste më shumë, se mesatarja e pesë viteve, e cila shënon 203 emigrantë të huaj të parregull.

Në krahasim me muajin shkurt 2025 gjatë të cilit janë shënuar 89 emigrantë të huaj, në muajin shkurt 2026 vihet re një rritje me 180 emigrant të huaj të parregull të kapur në vend. Në muajin janar 2026 janë shënuar 81 raste dhe në muajin shkurt 2026 ka pasur rritje me 88 raste më shumë.

Përgjatë periudhës janar-shkurt 2026 janë shënuar 350 emigrantë të huaj të parregull dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë ka rritje me 185 imigrantë më shumë.



Analiza e kthimeve (vullnetare+azilkërkues të refuzuar, forcërisht)




Analiza shpjeguese

Kthimet (Vullnetare+Azilkërkues të refuzuar forcërisht)

Gjatë periudhës pesëvjeçare shkurt 2022-2026, trendi i kthimeve vullnetare ka qenë i luhatshëm duke shënuar nivelin më të lartë të kthimeve (vullnetare, azilkërkues të refuzuar, forcërisht) në muajin shkurt 2024 me 742 persona.

Niveli më i ulët është shënuar në muajin shkurt 2022 me 453 persona. Në muajin shkurt 2026 u shënuan 96 raste më pak se mesatarja e periudhës pesë vjeçare, e cila shënon 579 raste të kthimeve (vullnetare, azilkërkues të refuzuar, forcërisht). Në raport krahasimor me muajin shkurt 2025, është shënuar 25% më pak raste e kthimeve vullnetare, gjithashtu krahasuar me muajin janar 2026 ka rënie me 15%.

Përgjatë periudhës janar-shkurt 2026 janë shënuar 1,052 kthime vullnetare dhe azilkërkues të refuzuar forcërisht dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë ka rënie me 240 kthime më pak.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Analiza krahasuese të veprave penale mes qarqeve Shkurt 2026

Gjetjet Kryesore

- Në total në shkallë vendi në muajin shkurt 2026 janë evidentuar 2,668 vepra penale.
- Kjo nënkupton një rritje me 7.6% ose 189 vepra penale më pak krahasuar me muajin e mëparshëm.
- Rreth 46% e rasteve të veprave penale kanë ndodhur në qarkun e Tiranës.
- Gjatë muajit shkurt 2026 ka pasur 2 raste të vrasjes me dashje dhe krahasuar me muajin e mëparshëm vihet re i njëjti trend.
- Numri i aksidenteve rrugore në muajin shkurt 2026 ka qenë 96 duke shënuar rritje me 1 rast, krahasuar me muajin janar 2026.
- Numri i rasteve të korrupsionit ka shënuar rritje me 15 raste në raport me muajin janar 2026, nga 41 në 56 raste. Numri i autorëve të kësaj vepre penale ka shënuar rritje me 52 autorë më shumë ose nga 62 autorë në 114.

Vepra Penale në Vend të Evidentuara në Shkurt 2026

Qarku	Tiranë	Durrës	Elbasan	Korçë	Gjirokastrë	Berat	Fier	Kukës	Vlorë	Dibër	Lezhë	Shkodër	Total
Vepra Penale të Evidentuara	1,240	262	117	155	62	80	159	60	185	47	142	159	2,668


Analiza Shpjeguese

Vepra Penale të Evidentuara sipas Qarqeve


Për muajin shkurt 2026, qarku me numrin më të madh të veprave penale është qarku i Tiranës me 1,240 vepra të evidentuara ose 46% e totalit të veprave penale për këtë muaj, ndjekur më pas nga qarku Durrës (9.8%). Ndërsa qarku me numrin më të vogël të veprave penale të evidentuara është qarku i Dibrës me 1.8%.

Gjatë muajit shkurt vihet re një rritje e veprave penale me 59% në qarkun e Gjirokastrës. Rënia më e madhe e veprave penale, evidentohet në qarkun Berat me 21%.

Vepra Penale të Evidentuara sipas Qarqeve ndaj Totalit të Veprave Penale (në %), Janar 2026



Vepra Penale të Evidentuara sipas Qarqeve, Dhjetor 2025 - Janar 2026 (Ndryshim mujor në %)



Analiza e Veprës Penale 'Vrasje me Dashje'

Qarku	Tiranë	Durrës	Elbasan	Korçë	Gjirokastër	Berat	Fier	Kukës	Vlorë	Dibër	Lezhë	Shkodër	Total
Vrasje me Dashje/ raste	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2
Vrasje me Dashje/ viktima	1	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	2

Analiza Shpjeguese


Vepra Penale të Evidentuara "Vrasje me dashje/raste"

Gjatë muajit janar 2025 janë evidentuar 2 raste për veprën penale të kategorisë "Vrasje me dashje", në muajin shkurt 2026, vihet re i njëjti numër rastesh.


Vepra Penale të Evidentuara "Vrasje me dashje/viktima"

Përsa i përket numrit të viktimave të shënuara nga veprat penale "Vrasje me dashje", gjatë muajit shkurt 2026 ka patur 2 viktima si pasojë e vrasjeve me dashje, shënohet i njëjti numër rastesh, krahasuar me muajin janar 2025.

Ndryshimi në % i numrit të veprës penale "Vrasje me dashje/ raste"
Janar 2026 - Shkurt 2026



Ndryshimi në % i numrit të veprës penale "Vrasje me dashje/ viktima"
Janar 2026 - Shkurt 2026



Analiza Mujore për "Aksidente Rrugore"


Qarku	Tiranë	Durrës	Elbasan	Korçë	Gjirokastër	Berat	Fier	Kukës	Vlorë	Dibër	Lezhë	Shkodër	Total
Aksidente Rrugore (Nr)	42	9	2	7	4	0	1	7	10	0	9	6	97
Aksidente Rrugore me pasojë vdekjen (Nr)	5	2	0	0	0	0	1	1	1	0	2	0	12

Analiza Shpjeguese


Vepra Penale "Aksidente Rrugore"

Për muajin shkurt 2026, qarku me numrin më të madh të aksidenteve rrugore vijon të mbetet qarku i Tiranës, me 42 aksidente të evidentuara ose 43.3% të totalit të aksidenteve në shkallë vendi. Në qarqet Berat dhe Dibër për muajin shkurt nuk është shënuar asnjë aksident, duke shënuar dhe numrin më të ulët. Gjatë muajit shkurt 2026 janë shënuar 12 viktima në aksidente.

"Aksidente Rrugore" sipas qarqeve, pesha ndaj totalit në (%) Shkurt 2026



"Aksidente Rrugore me pasojë Vdekjen" pesha ndaj totalit sipas qarqeve, Shkurt 2026





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Integriteti dhe Besimi në Polici

Shkurt 2026

Integriteti dhe Besimi në Polici

Kodi	Kategoria	Muaji					
		Shkurt 2022	Shkurt 2023	Shkurt 2024	Shkurt 2025	Janar 2026	Shkurt 2026
1	Vepra penale të evidentuara	8	13	32	28	25	32
2	Policë të proceduar penalisht	12	21	39	30	28	27
3	Policë të arrestuar	5	9	8	10	11	4
4	Ankesa në linjën 0800 90 90	352	291	356	368	223	169

Gjetjet Kryesore



Gjatë muajit shkurt 2026 numri i veprave penale të evidentuara në radhët e punonjësve të policisë ka qenë 32 dhe krahasuar me muajin shkurt 2025, janë shënuar 4 vepra penale më shumë, gjithashtu krahasuar me muajin janar 2026, ka rritje me 7 raste më shumë.



Numri i policëve të proceduar penalisht, gjatë muajit shkurt 2026 shënon 27 policë të proceduar penalisht dhe krahasuar me muajin shkurt 2025, ka rënie me 3 policë të proceduar penalisht më pak, gjithashtu krahasuar me muajin e mëparshëm janar 2026, ka rënie me 1 rast më pak.



Numri i policëve të arrestuar gjatë muajit shkurt të vitit 2026, ka shënuar 4 policë të arrestuar dhe krahasuar me muajin shkurt 2025, ka rënie me 6 policë të arrestuar më pak, gjithashtu krahasuar me muajin janar 2026, ka rënie me 7 raste më pak.



Numri i ankesave në linjën e gjelbër 08009090, gjatë muajit shkurt 2026, ka shënuar 169 ankesa dhe krahasuar me muajin shkurt 2025, janë shënuar 199 ankesa më pak, gjithashtu në raport krahasimor me muajin e mëparshëm janar 2026 ku janë shënuar 223 ankesa, ka rënie me 54 ankesa më pak.

Vepra penale të evidentuara mbi Integritetin në Polici

Analiza Shpjeguese




Numri i veprave penale të evidentuara mbi integritetin në polici

Gjatë analizës së muajve shkurt për periudhën 2022-2026 veprat penale të evidentuara mbi integritetin në polici, kanë shënuar vlerën më të lartë në muajin shkurt të vitit 2024 dhe 2026 me 32 raste, ndërsa vlerën më të ulët në muajin shkurt 2022 me 8 raste. Krahasuar me muajin shkurt të një viti më parë ka shënuar rritje me 4 vepra penale më shumë.

Krahasuar me mesataren e muajve shkurt 2022-2026, e cila shënon përafërsisht 23 vepra penale të evidentuara lidhur me integritetin në polici, në muajin shkurt të vitit 2026, ka rritje me 9 vepra më shumë.

Në muajin janar 2026, janë shënuar 25 raste dhe krahasuar me muajin shkurt 2026, ka rritje me 7 raste më shumë.

Përgjatë periudhës janar-shkurt 2026 janë shënuar 57 vepra penale, dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë ka rënie me 2 vepra penale më pak.



Analiza Shpjeguese

Numri i policëve të proceduar penalisht




Gjatë analizës së muajve shkurt 2022-2026, numri i policëve të proceduar penalisht ka shënuar vlerën më të lartë në muajin shkurt të vitit 2024 me 39 policë të proceduar penalisht. Numri më i ulët i punonjësve të proceduar penalisht është shënuar në muajit shkurt të vitit 2022 me nga 12 policë.

Krahasuar me mesataren e muajve janar të periudhës 2022-2026, e cila shënon mesatarisht 26 policë të proceduar penalisht, në muajin shkurt 2026, vihet re një rritje me 1 rast shumë.

Në muajin shkurt të vitit 2026 janë shënuar 27 të proceduar penalisht dhe krahasuar me muajin shkurt të vitit 2025, gjatë të cilit janë shënuar 30 policë, vihet re rënie me 3 policë të proceduar penalisht më pak.

Përgjatë periudhës janar-shkurt 2026 janë shënuar 55 policë të proceduar penalisht dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ka rënie me 32 policë të proceduar më pak.

Policë të proceduar penalisht



Analiza Shpjeguese

Numri i policëve të arrestuar




Gjatë analizës së muajve shkurt për periudhën 2022-2026, numri i policëve të arrestuar ka shënuar vlerën më të lartë në muajin shkurt të vitit 2025 me 10 policë të arrestuar dhe në muajin shkurt të vitit 2026 ka shënuar vlerën më të ulët me 4 policë të arrestuar.

Krahasuar me mesataren e muajve shkurt 2022-2026, e cila shënon mesatarisht 7 policë të arrestuar, gjatë muajit shkurt 2026, ka 3 policë të arrestuar më pak se mesatarja. Krahasuar me muajin shkurt të një viti më parë, ka 6 policë të arrestuar më pak.

Në raport krahasimor me muajin janar 2026, ku janë shënuar 11 policë të arrestuar, në muajin shkurt 2026, ka rënie me 7 policë të proceduar penalisht më pak.

Përgjatë periudhës janar-shkurt 2026 janë shënuar 15 vepra penale dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë ka rënie me 14 policë të arrestuar më pak.

Policë të arrestuar



Analiza Shpjeguese

Numri i ankesave në linjën 0800 90 90




Gjatë analizës së muajve shkurt për periudhën 2022-2026, numri i ankesave në linjën 0800 90 90 ka shënuar vlerën më të lartë në shkurt të vitit 2025 me 368 ankesa dhe vlerën më të ulët të ankesave në shkurt të vitit 2026 me 169 ankesa në linjën 0800 90 90.

Krahasuar me mesataren e muajve shkurt të viteve 2022-2026, e cila shënon mesatarisht 307, numri i ankesave në linjën 0800 90 90, në muajin shkurt 2026, ka shënuar rënie me 138 ankesa më pak.

Në krahasim me muajin shkurt të vitit 2025, ku janë shënuar 368 ankesa në linjën e gjelbërt 0800 90 90, në muajin shkurt 2026 është shënuar rënie me 199 ankesa më pak.

Përgjatë periudhës janar-shkurt 2026 ka pasur 392 ankesa në linjën 0800 90 90 dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë ku janë shënuar 521 ankesa, ka rënie 25% më pak, ose 129 ankesa më pak.

Ankesa në linjën 0800 90 90





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Analiza e Treguesve të Gjendjes Civile

Shkurt 2025

Analiza e Treguesve të Gjendjes Civile

Kodi	Kategoria	Muaji					
		Shkurt 2022	Shkurt 2023	Shkurt 2024	Shkurt 2025	Janar 2026	Shkurt 2026
1	Zgjidhje e rasteve të aplikimeve të vonuara (shkëmbin NID etj)	20	27	25	32	20	26
2	Verifikim akt lindje të mbajtura në Përfaqësitë Diplomatike	4	11	14	5	25	16
3	Verifikim akt martese të mbajtura në Përfaqësitë Diplomatike	19	16	8	2	22	5
4	Verifikim të përbërësve të gjc për subjektet e ngarkuara me ligj (Përmbaram , M	120	221	247	210	140	100
5	Verifikim të përbërësve të gjc për subjektet e ngarkuara me ligj (Perf. Diplomati	220	215	123	120	155	150
6	Verifikim të përbërësve të gjc për subjektet e ngarkuara me ligj (PSH, KQZ, KPK,	320	113	295	1,000	280	210
7	Akte lindje të mbajura nga shërbimi i gjc në bashki/njs.adm	1,961	1,820	1,719	1,665	2,003	2,085
8	Akte martese të mbajura nga shërbimi i gjc në bashki/njs.adm	1,325	1,331	1,165	1,065	2,235	2,268
9	Akte vdekje të mbajura nga shërbimi i gjc në bashki/njs.adm	2,968	1,932	2,004	1,948	2,013	2,279
10	Ndryshim vendbanimi	4,904	5,943	3,048	4,930	3,450	4,820
11	Aplikime (ID)	26,529	21,156	16,229	18,987	16,421	17,180
12	Aplikime (PASS)	36,723	30,917	30,352	28,292	21,915	25,107



Numri i zgjidhjeve të rasteve të aplikimeve të vonuara (shkëmbin NID etj) në muajin shkurt 2026 shënon rënie me 6 raste, në krahasim me muajin shkurt 2025, ndërsa në krahasim me muajin janar 2026, shënohet rritje me 6 raste.



Verifikimi i akt lindjeve të mbajtura në Përfaqësitë Diplomatike në muajin shkurt 2026 ka shënuar rritje me 11 akte lindjeje, krahasuar me muajin shkurt 2025, ndërsa, në raport me muajin paraardhës janar 2026, vihet re rënie me 9 raste.



Numri i aplikimeve për ID në shkurt 2026 ka shënuar rënie me 1 807 raste të aplikimeve, në krahasim me muajin shkurt 2025, ndërsa, krahasuar me muajin janar 2026 vihet re rritje me 5% të aplikimeve.



Numri i aplikimeve për pasaportë në muajin shkurt 2026 ka shënuar rënie me 3 185 aplikime më pak, krahasuar me muajin shkurt 2025, ndërsa, krahasuar me muajin janar 2026 vihet re rritje me 3 192 aplikime.



Zgjidhjet e rasteve të Aplikimeve të Vonuara

Analiza Shpjeguese

Numri i zgjidhjeve të rasteve të aplikimeve të vonuara

Numri i zgjidhjeve të rasteve të aplikimeve të vonuara për periudhën 2022-2026, ka shënuar vlerën më të lartë në muajin shkurt të vitit 2025 me 32 raste, ndërsa vlerën më të ulët në shkurt të vitit 2022 me 20 raste. Në shkurt të vitit 2026, janë shënuar 26 raste të zgjidhjeve të aplikimeve të vonuara (shkëmbim NID, etj), shënohet rënie me 6 raste, krahasuar me të njëjtin muaj të një viti më parë.

Në raport me muajin janar 2026, në muajin shkurt 2026, vihet re rritje, me 6 raste të zgjidhjeve të aplikimeve të vonuara.





Verifikim akt lindje të mbajtura në Përfaqësitë Diplomatike

Analiza Shpjeguese

Verifikim akt lindje të mbajtura në Përfaqësitë Diplomatike

Numri i verifikimeve të akt lindjeve të mbajtura në Përfaqësitë Diplomatike për periudhën 2022-2026, ka shënuar vlerën më të lartë me 16 raste në muajin shkurt të vitit 2026 dhe vlerën më të ulët e ka shënuar në muajin shkurt të vitit 2022, me 4 raste të evidentuara. Krahasuar me mesataren e muajve shkurt të viteve 2022-2026, e cila shënon mesatarisht 10 raste, në shkurt 2026 shënohet rritje me 6 verifikimeve të akt lindjeve të mbajtura nga përfaqësitë diplomatike.

Në krahasim me muajin shkurt 2025, në muajin shkurt të 2026 shënohet rritje me 11 verifikime akt lindjeje të mbajtur në përfaqësitë diplomatike, ndërsa, në krahasim me muajin paraardhës janar 2026, vihet re rënie, me 9 verifikime të akt lindjeve.





Verifikim akt martese të mbajtura në Përfaqësitë Diplomatike

Analiza Shpjeguese

Verifikim akt martese të mbajtura në përfaqësitë diplomatike

Gjatë periudhës shkurt 2022-2026, numri i verifikimeve të akt martesave të mbajtura në përfaqësitë diplomatike, ka një trend të luhatshëm, në muajin shkurt të vitit 2022 ka shënuar nivelin më të lartë me 19 të tilla, ndërsa nivelin më të ulët në shkurt të vitit 2025 me 2 akte. Në muajin shkurt 2026 vihet re rënie me 5 raste, krahasuar me mesataren e periudhës e cila shënon mesatarisht 10 raste. Krahasuar me muajin shkurt 2025, është shënuar rritje me 3 akte.

Në krahasim me muajin janar 2026, gjatë të cilit janë shënuar 22 verifikime akte martesë të mbajtura në përfaqësitë diplomatike, në muajin shkurt 2026, vihet re rënie me 17 raste.





Verifikimet e përbërësve të gjendjes civile për subjektet e ngarkuara me ligj (Përmbarrim , MD , shërbim prove)

Analiza Shpjeguese

Numri i verifikimeve të përbërësve të gjendjes civile për subjektet e ngarkuara me ligj (Përmbarrim , MD , shërbim prove)

Numri i verifikimeve të përbërësve të gjendjes civile për subjektet e ngarkuara me ligj (Përmbarrim, MD, Shërbim prove) gjatë periudhës shkurt 2022-2026, ka shënuar vlerën më të lartë në shkurt 2024 me 247 verifikime, ndërsa në shkurt 2026 janë numëruar 100 raste të tilla ku është shënuar edhe vlera më e ulët. Në krahasim me mesataren e periudhës së marrë në studim, e cila shënon 180 verifikime, në shkurt 2025 shënohet rënie me 80 raste. Në krahasim me të njëjtin muaj një vit më parë ka shënuar rënie me 52% të rasteve.

Në krahasim me muajin janar 2026, gjatë të cilit janë shënuar 140 verifikime të përbërësve të gjendjes civile për subjektet e ngarkuara me ligj, në muajin shkurt 2026 shënohet rënie me 40 raste.





Verifikim të përbërësve të gjendjes civile për subjektet e ngarkuara me ligj (PSH, KQZ, KPK, Prokuroria, DAP)

Analiza Shpjeguese

Numri i verifikimeve të përbërësve të gjc për subjektet e verifikuara me ligj, (PSH, KQZ, KPK, Prokuroria, DAP)

Gjatë periudhës së analizuar shkurt 2022-2026, numri i verifikimeve të përbërësve të gjendjes civile për subjektet e ngarkuara me ligj (PSH, KQZ, KPK, Prokuroria, DAP) ka shënuar numrin më të lartë në shkurt të vitit 2025 me 1000 raste dhe numrin më të ulët në shkurt 2023 me 113 raste. Gjatë muajit shkurt 2026, vihet re rënie me 790 raste, krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ndërsa, krahasuar me mesataren e muajve shkurt të viteve 2022-2026, e cila shënon mesatarisht 388 raste, në shkurt 2025 kemi një rënie me 178 verifikime.

Në krahasim me muajin janar 2026, ku janë regjistruar 280 verifikime, në shkurt 2026 vihet re rënie me 25%.





Analiza e rasteve të ndryshimit të vendbanimit

Analiza Shpjeguese

Numri i rasteve të ndryshimit të vendbanimit

Referuar analizës së muajve shkurt për periudhën e marrë në studim 2022-2026, niveli më i lartë i rasteve të ndryshimit të vendbanimit është në shkurt 2023 me 5 943 raste, ndërsa niveli më i ulët është në shkurt 2024 me 3 048.

Në krahasim me muajin janar 2026 ku janë shënuar 3 450 raste të ndryshimit të vendbanimit, gjatë muajit shkurt 2026, shënohet rritje me me 1 370 raste.





Analiza Shpjeguese

Numri i Aplikimeve për ID

Gjatë periudhës së analizuar shkurt 2022-2026, numri i aplikimeve për ID ka shënuar vlerën më të lartë në shkurt 2022 me 26 529 raste dhe vlerën më të ulët në shkurt 2024 me 16 229 raste. Gjatë muajit shkurt 2026 shënohet rënie e aplikimeve për ID me 14% krahasuar me mesataren e muajve shkurt 2022-2026.

Në krahasim me muajin janar 2026, ku janë regjistruar 16 421 aplikime për ID, në shkurt 2026, vihet re rritje me 5% e numrit të aplikimeve.

Analiza e aplikimeve për ID





Analiza Shpjeguese

Numri i Aplikimeve për Pasaporta

Gjatë periudhës shkurt 2022-2026, numri i aplikimeve për pasaporta ka shënuar vlerën më të lartë në shkurt 2022 me 36 723 raste dhe numrin më të ulët në shkurt 2026 me 25 107 raste. Në shkurt të vitit 2026, shënohet rënie me 17% e aplikimeve për pasaporta, krahasuar mesataren e muajve shkurt 2022-2026.

Krahasuar me muajin janar 2026 numri i aplikimeve për pasaporta, në shkurt 2026 ka shënuar rritje me 14.6%.

Analiza e aplikimeve për Pasaporta





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Analiza e veprimtarisë së Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit

Shkurt 2026

Analiza e veprimtarisë së Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit (IKMT)

Kodi	Kategoria	Muaji					
		Shkurt 2022	Shkurt 2023	Shkurt 2024	Shkurt 2025	Janar 2026	Shkurt 2026
1	Objekte/ndërtime të prishura, të cilat janë ndërtuar në kundërshtim me ligjin / VKM shpronësimi	4	16	125	17	85	0
1	Inspektime	412	268	880	360	368	266
2	Ankesa/Shkresa/Platforma	465	587	689	970	708	885
3	Gjoha mbi zbatimin e ligjshmërisë tek produktet ndërtimit	3	1	0	0	0	0
4	Gjoha të vëna ndaj Kryeinspektorëve/inspektorëve pranë IMT- të Bashkive për veprime/mosveprimet e t	6	0	0	0	3	0
7	Objekte të prishura nga tërmeti i 26 Shkurtit	0	0	0	0	0	0
8	Gjoha të vëna në ndërtimet pa leje	0	11	43	8	3	0
9	Vendim prishje te objekteve te kundraligjshme/pezullimi të punimeve në ndërtim	12	4	107	6	3	0
10	Kallëzime penale për veprat penale të vëna re gjatë ushtrimit të kontrollit dhe paraqitja pranë organeve	0	0	0	0	0	0

Gjetjet Kryesore



Gjatë muajit shkurt 2026, nuk ka pasur asnjë objekt të prishura dhe shënohet rënie me 17 objekte, në krahasim me muajin shkurt 2025, ku janë shënuar 17 raste, gjithashtu në raport me muajin janar 2026, vihet re rënie me 85 raste.



Numri i inspektimeve, gjatë muajit shkurt 2026, ka shënuar rënie me 94 raste, në raport me muajin shkurt të vitit 2025, ku gjatë të cilit janë shënuar 360 raste, ndërsa në krahasim me muajin paraardhës janar 2026 shënohet rënie me 102 inspektime.



Numri i Ankesave/Shkresave gjatë muajit shkurt 2026 ka shënuar rënie me 85 Ankesa/Shkresa, në krahasim me muajin shkurt 2025, gjatë të cilit u shënuan 970 raste. Në raport me muajin janar të vitit 2026 shënohet rënie me 177 Ankesa/Shkresa.



Numri i gjobvënieve për ndërtimet pa leje, gjatë muajit shkurt 2026 në krahasim me muajin shkurt 2025, shënon rënie me 8 gjobë të vëna, ndërsa në krahasim me muajin janar 2026, vihet re rënie me 3 raste.



Numri i vendimeve për prishje të objekteve të kundraligjshme gjatë muajit shkurt 2026, ka shënuar rënie me 6 vendime, në krahasim me muajin shkurt 2025 ku janë evidentuar 6 vendim prishjeje. Në raport me muajin janar 2026, vihet re rënie, me 3 vendime për prishje të objekteve të kundraligjshme.


Analiza Shpjeguese

Numri i objekteve të prishura


Gjatë analizës për periudhën shkurt 2022- 2026, numri i objekteve të prishura ka shënuar vlerën më të lartë në muajin shkurt të vitit 2024 me 125 objekte dhe vlerën më të ulët në muajin shkurt të vitit 2026 me asnjë objekt të prishur. Përsa i përket muajit shkurt të vitit 2026, nuk është shënuar asnjë objekt të prishur ose 32 raste më pak se niveli mesatar i muajve shkurt për vitet 2022-2026, e cila ka shënuar mesatarisht 32 objekte të prishura. Në krahasim me muajin shkurt 2025, ku nuk është shënuar asnjë objekt i prishur, në muajin shkurt 2026 vihet re rënie me 17 raste.

Në krahasim me muajin janar të vitit 2026, gjatë të cilit janë prishur 85 objekte, në muajin shkurt 2026, vihet re rënie.

Numri i objekteve të prishura



Objekte/Ndërtime të prishura (Ndryshim mujor në %)



Analiza Shpjeguese

Numri i Inspektimeve



Numri më i madh i inspektimeve për periudhën e muajve shkurt të viteve 2022-2026, është shënuar në muajin shkurt të vitit 2026 me 880 raste, ndërsa vlera më e vogël është shënuar në muajin shkurt 2026 me 266 raste.

Përsa i përket muajit shkurt të vitit 2026, janë shënuar 266 inspektime ose 171 raste më pak se niveli mesatar i muajve shkurt për vitet 2022-2026, që shënon mesatarisht 437 inspektime.

Në krahasim me muajin shkurt të vitit të kaluar ku janë shënuar 360 inspektime, në muajin shkurt 2026, shënohet rënie me 94 inspektime.

Në krahasim me muajin janar 2026, ku janë evidentuar 368 inspektime, gjatë muajit shkurt 2026, shënohet rënie me 102 inspektime.

Numri i Inspektimeve



Analiza Shpjeguese

Numri i Ankesave/shkresave/platformave



Numri më i madh i Ankesave/Shkresave/Platformave evidentohet në muajin shkurt të vitit 2025 me 970 ankesa të tilla, ndërsa numri më i ulët vihet re në muajin shkurt 2022 me 465 raste.

Përsa i përket muajit shkurt 2026, vihet re rritje me 166 ankesa/shkresa/platforma më shumë se niveli mesatar i muajve shkurt të viteve 2022-2026, që shënon mesatarisht 719 raste.

Në krahasim me muajin shkurt të vitit të kaluar ku janë shënuar 970 ankesa/shkresa/platforma, në muajin shkurt 2026 shënohet rënie e numrit të tyre me 85 raste më shumë.

Në raport me muajin janar 2026, gjatë të cilit janë shënuar 708 ankesa/shkresa/platforma, në muajin shkurt 2026 vihet re rritje me 25% e numrit të tyre.

Numri i Ankesave/Shkresave/Platformave



Numri i gjobave të vëna në ndërtimet pa leje



Analiza Shpjeguese

Gjopa të vëna në ndërtimet pa leje

Për muajin shkurt të viteve 2022-2026, numri më i lartë i gjobave të vëna në ndërtimet pa leje, ka qenë në muajin shkurt të vitit 2024, gjatë të cilit janë shënuar 43 raste ndërsa niveli më i ulët është shënuar në muajin shkurt të viteve 2022 dhe 2026, me asnjë raste të evidentuara.

Në krahasim me muajin shkurt të vitit të kaluar ku janë shënuar 8 gjoba, në muajin shkurt 2026 vihet re rënie me 8 raste. Gjatë muajit shkurt 2026 nuk është shënuar asnjë gjobë në ndërtimet pa leje, vihet re rënie me 12 gjoba, krahasuar me mesataren e periudhës së marrë në analizë shkurt 2022-2026, e cila shënon mesatarisht 12 gjoba të vëna në ndërtimet pa leje.

Në krahasim me muajin janar të vitit 2026, ku janë shënuar 3 gjoba në ndërtimet pa leje, në muajin shkurt 2026 vihet re rënie me 3 gjoba.





Vendim për prishje të objekteve të kundraligjshme/pezullimi i punimeve në ndërtim

Analiza Shpjeguese

Vendim për prishje të objekteve të kundraligjshme/pezullimi i punimeve në ndërtim (Nr.)

Numri më i madh i vendimeve për prishjeve të objekteve të kundraligjshme apo pezullimin e punimeve në ndërtim, për muajt shkurt të viteve 2022-2026, është shënuar në muajin shkurt të vitit 2024 me 107 vendime prishje të objekteve të kundraligjshme, ndërsa në muajin shkurt të vitit 2026 është shënuar niveli më i ulët me asnjë vendim prishje. Përsa i përket muajit shkurt 2026, ku nuk është marrë asnjë vendime prishje të objekteve të kundraligjshme, shënohet rënie me 26 vendime më pak se niveli mesatar i muajve shkurt 2022-2026, që shënon mesatarisht 26 raste. Në krahasim me muajin shkurt të vitit të kaluar ku janë shënuar 6 vendime për prishje të objekteve të kundraligjshme, në muajin shkurt 2026 ka pasur rënie me 6 vendime.

Në krahasim me muajin janar të vitit 2026, gjatë të cilit janë shënuar 3 raste, në muajin shkurt 2026, vihet re rënie e vendimeve për prishje të objekteve të kundraligjshme/pezullimi i punimeve në ndërtim.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Analiza e Indikatorëve të Azilit dhe Shtetësisë

Shkurt 2026

Analiza e Azilit dhe Shtetësisë

Kodi		Muaji					
		Shkurt 2022	Shkurt 2023	Shkurt 2024	Shkurt 2025	Janar 2026	Shkurt 2026
A	Azili						
A1	Kërkesat për azil	17	11	1	2	2	17
A13	Numri i vendimeve për pushimin e procedurës të shqyrtimit të aplikimit për azil;	0	3	0	0	0	2
A15	Numri i vendimeve për pezullimin e procedurës të shqyrtimit të aplikimit për azil;	0	1	0	0	0	0
SH	Shtetësia						
Sh1	Kërkesat për lënie të shtetësisë shqiptare	30	93	67	23	32	17
Sh1.1	Sa janë kthyer	10	70	12	1	1	0
Sh1.2	Kërkesa për lënie shtetësie përcjellë në Presidencë	27	37	35	15	21	27
Sh2	Kërkesat për fitim të shtetësisë shqiptare	87	176	72	78	42	48
Sh 2.1	Kërkesa të kthyer për fitim të shtetësisë shqiptare	23	101	29	21	15	15
Sh 2.2	Sa janë përcjellë në Presidencë për fitim të shtetësisë shqiptare	38	83	31	37	31	39

Gjetjet Kryesore

Numri i kërkesave për azil gjatë muajit shkurt 2026 ka shënuar 17 kërkesa për azil dhe krahasuar me muajin shkurt 2025 ka rritje 15 kërkesa, gjithashtu krahasuar me muajin janar 2026, ka rritje me 15 kërkesa për azil më shumë.

Numri i vendimeve për pushimin e procedurës së shqyrtimit të aplikimit për azil, në muajin shkurt 2026 ka pasur 2 raste dhe krahasuar me muajin shkurt 2025 dhe janar 2026, ka rritje me 2 raste më shumë.

Në shkurt 2026 janë shënuar 17 kërkesa për lënie të shtetësisë shqiptare dhe krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, ka rënie me 6 kërkesa më pak, gjithashtu në raport me muajin janar 2026, ka rënie me 15 kërkesa më pak.

Gjatë muajit shkurt 2026 janë evidentuar 27 kërkesa për fitim të shtetësisë shqiptare dhe në raport me muajin shkurt 2025 vihet re rritje 12 kërkesa më shumë, gjithashtu krahasuar me muajin janar 2026 ka rritje me 6 kërkesa më shumë.

Numri i kërkesave për fitim të shtetësisë të përcjella në Presidencë në muajin shkurt 2026 shënon 2 kërkesa më shumë dhe krahasuar me muajin shkurt 2025, gjatë të cilit janë shënuar 37 kërkesa, ndërsa në raport me muajin janar 2026, ka rritje me 8 kërkesa më shumë.



Analiza shpjeguese

Kërkesat për azil gjatë periudhës 5-vjeçare shkurt 2022-2026, numrin më të lartë e kanë shënuar në muajin shkurt 2022 dhe 2026 me 17 kërkesa dhe numrin më i ulët në muajin shkurt 2024 me 1 kërkesë. Krahasuar me mesataren e periudhës shkurt 2022-2026, e cila shënon 10 kërkesa, në muajin shkurt 2026 ka rritje me 7 kërkesa më shumë.

Në muajin shkurt 2025 janë shënuar 2 raste dhe krahasuar me muajin shkurt 2026, ka rritje me 15 kërkesa më shumë.

Gjatë periudhës janar-shkurt 2026, ka pasur 25 kërkesa për azil dhe krahasuar me muajin janar-shkurt 2025 ka rritje me 18 kërkesa më shumë.

Analiza e Kërkesave për Azil



Analiza Shpjeguese



Kërkesa për lënie të Shtetësisë

Kërkesat për lënie të shtetësisë shqiptare gjatë muajit shkurt 2026 janë 17 kërkesa dhe krahasuar me muajin janar 2026, gjatë të cilit janë shënuar 32 kërkesa, ka rënie me 15 kërkesa ose 47% më pak.

Kërkesa për lënie shtetësie përcjellë në presidencë

Numri i kërkesave për lënie të shtetësisë shqiptare përcjellë në presidencë gjatë muajit shkurt 2026 është 27 kërkesa dhe krahasuar me muajin janar 2026 gjatë të cilit ka 21 kërkesa, ka rritje me 6 raste më shumë.

Kërkesat për lënie të shtetësisë shqiptare



Analiza Shpjeguese



Kërkesa për fitim të Shtetësisë

Në lidhje me kërkesat për fitim të shtetësisë shqiptare gjatë muajit shkurt 2026 janë shënuar 48 kërkesa dhe krahasuar me muajin janar të vitit 2026 gjatë të cilit ka pasur 42 kërkesa, ka rritje me 6 kërkesa ose 14% më shumë.

Kërkesa të kthyera dhe të përcjella në presidencë për fitimin e shtetësisë Shqiptare

Niveli më i lartë i kërkesave të kthyera shënohet në muajin shkurt 2023 me 101 kërkesa dhe më i vogël në muajin shkurt 2026 me 15 kërkesa të kthyera. Gjatë muajit shkurt 2023 shënohet numri më i lartë i kërkesave të përcjella në Presidencë me 83 kërkesa, ndërsa niveli më i ulët shënohet në muajin shkurt 2024 me 31 kërkesa.

Kërkesa për lënie dhe për fitim shtetësie



Analiza Shpjeguese

Kërkesat për rifitimin e shtetësisë shqiptare



Gjatë periudhës 5-vjeçare shkurt 2022-2026, numri i kërkesave për rifitim të shtetësisë ka shënuar vlerën më të lartë në shkurt 2026 me 31 raste të evidentuara, ndërsa në muajin shkurt 2024 është shënuar vlera më e ulët me 4 kërkesa.

Në krahasim me mesataren e muajve shkurt e cila është 16 kërkesa për rifitim të shtetësisë, në shkurt 2026 vihet re një rritje me 15 kërkesa më shumë. Krahasuar me muajin shkurt 2025 gjatë të cilit janë shënuar 29 për rifitimin e shtetësisë shqiptare, në muajin shkurt 2026 vihet re rritje 2 kërkesa më shumë.

Kërkesat e përcjella dhe të kthyera nga Presidencia për rifitim të shtetësisë Shqiptare

Në muajin shkurt 2025 shënohet vlera më e lartë e kërkesave të kthyera 25 raste, ndërsa vlera më e ulët në muajin shkurt 2026 me 0 raste. Kërkesat e përcjella në Presidencë kanë shënuar vlerën më të lartë në muajin shkurt 2026 me 7 kërkesa dhe vlerën më të ulët në vitin 2024 me 1 kërkesë.

Kërkesat për rifitim të shtetësisë shqiptare





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Analiza e Sektorit të Marrëveshjeve Shkurt 2026

Analiza e Sektorit të Marrëveshjeve

Kodi	Kategoria	Muaji					
		Shkurt 2022	Shkurt 2023	Shkurt 2024	Shkurt 2025	Janar 2026	Shkurt 2026
1 Akte ndërkombëtare në Proces							
1.1	Dypaleshe me vendet e BE	19	7	5	4	6	6
1.2	Dypaleshe me vendet e Rajonit	16	17	5	4	7	7
1.3	Dypaleshe me vende të tjera	7	24	0	14	23	23
2 Akte Ndërkombëtare të Nënshkuara							
2.1	Akte Ndërkombëtare të Nënshkuara me vendet e BE	0	0	1	1	0	1
2.2	Akte Ndërkombëtare të Nënshkuara me vendet e Rajonit	0	0	0	0	0	0
2.3	Akte Ndërkombëtare të Nënshkuara me vendet e Tjera	0	0	0	2	0	0
3 Akte Ndërinstitucionale							
3.1	Në proces	12	17	7	8	6	6
3.2	Akte Ndërinstitucionale të nënshkuara/miratuara	0	1	1	1	2	2

Gjetjet Kryesore



Gjatë muajit shkurt 2026, janë në proces 6 akte ndërkombëtare dypalëshe me vendet e BE dhe krahasuar me muajin shkurt 2025, ka rritje me 2 akte më shumë, ndërsa krahasuar me muajin janar 2026, nuk ka pësuar ndryshim.



Gjatë muajit shkurt 2026 janë 7 akte ndërkombëtare dypalëshe me vendet e rajonit dhe krahasuar me muajin shkurt 2025 ka rritje em 3 akte më shumë, ndërsa krahasuar me muajin janar 2026, nuk ka pësuar ndryshim.



Gjatë muajit shkurt 2026, janë 6 akte ndërinstitucionale në proces dhe krahasuar me muajin shkurt 2025, ka rënie me 2 akte më pak, ndërsa krahasuar me muajin janar 2026, nuk ka pësuar ndryshim.



Gjatë muajit shkurt 2026 ka pasur 2 akte ndërinstitucionale të nënshkuar/miratuara dhe krahasuar me muajin shkurt 2025 ka rritje me 1 akt më shumë, ndërsa krahasuar me muajin janar 2026, nuk ka pësuar ndryshim.

Analiza e Akteve Ndërkombëtare në Proces




Analiza Shpjeguese

Akte Ndërkombëtare

Në muajin shkurt të vitit 2026, janë shënuar 6 akte ndërkombëtare në proces me vendet e BE dhe krahasuar me muajin shkurt 2025, ka rritje me 2 akte më shumë.

Në muajin shkurt të vitit 2026, janë në proces 7 akte ndërkombëtare me vendet e rajonit dhe krahasuar me muajin shkurt të vitit 2025, ka rritje me 3 akte më shumë.

Në shkurt të vitit 2026, janë shënuar 23 akte ndërkombëtare në proces me vendet e tjera dhe krahasuar me muajin shkurt të vitit 2025, ka rritje 9 akte më shumë.



Analiza Shpjeguese




Akte Ndërkombëtare

Në shkurt të vitit 2026, është nëshkruar 1 akt ndërkombëtar me vendet e BE dhe krahasuar me muajin janar 2026, nuk ka pësuar ndryshim.

Në muajin shkurt të vitit 2026, nuk është nëshkruar asnjë akt ndërkombëtar me vendet e rajonit dhe krahasuar me muajin janar të vitit 2026, nuk ka pësuar ndryshim.

Në muajin shkurt të vitit 2025, nuk është nëshkruar akt ndërkombëtar me vendet e tjera dhe krahasuar me muajin janar 2026, nuk ka pësuar ndryshim.

Akte Ndërkombëtare





Akte Ndërinstitucionale në proces dhe të nënshkuara/miratuara

Analiza Shpjeguese

Akte Ndërinstitucionale

Akte ndërinstitucionale në proces gjatë periudhës 5-vjeçare shkurt 2022-2026, kanë shënuar nivelin më të lartë në muajin shkurt 2023 me 17 akte, ndërsa nivelin më të ulët në muajin shkurt të vitit 2026 me 6 akte. Krahasuar me muajin shkurt 2025, gjatë të cilit janë shënuar 8 akte, në muajin shkurt 2026 ka rënie me 2 akte më pak.

Akte ndërinstitucionale të nënshkuara/miratuara gjatë periudhës 5-vjeçare shkurt 2022-2026, kanë shënuar nivelin më të lartë në muajin shkurt 2026 me 2 akte, ndërsa nivelin më të ulët në muajin shkurt 2022, me 0 akt. Krahasuar me muajin shkurt 2025, gjatë të cilit është shënuar 1 akt, në muajin shkurt 2026, ka rritje me 1 akt më shumë.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Analiza e Qendrës Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit

Shkurt 2026

Analiza e Qendrës Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit

Kodi	Kategoria	Muaji					
		Shkurt 2022	Shkurt 2023	Shkurt 2024	Shkurt 2025	Shkurt 2026	Janar 2025
1	Numri i refugjatëve që trajtohen në qendër	0	0	0	0	6	0
2	Numri i azilkërkuesve që trajtohen në qendër	14	20	22	18	33	38
3	Numri i të miturve të pashoqëruar që kanë kërkuar azil	0	1	0	0	0	0

Gjetjet Kryesore



Gjatë muajit shkurt 2026 ka pasur 6 refugjatë që trajtohen në qendër. Krahasuar me të njëjtin muaj të një viti më parë shënohet rritje me 6 refugjatë. Gjithashtu, krahasuar me një muaj më parë janar 2026, vihet re rritje me 6 refugjat që trajtohet në qendër.



Gjatë muajit shkurt 2026 janë shënuar 33 raste të azilkërkuesve që trajtohen në qendër, duke shënuar rritje me 15 azilkërkues krahasuar me muajin shkurt të një viti më parë. Krahasuar me muajin janar 2026, numri i azilkërkuesve që trajtohen në qendër ka shënuar rënie me 5 raste.



Numri i të miturve të pashoqëruar që kanë kërkuar azil nuk ka shënuar asnjë rast gjatë muajit shkurt 2026, krahasuar me muajin shkurt të vitit 2025 shënohet i njëjti trend. Gjithashtu, në raport me muajin paraardhës janar 2026, është shënuar i njëjti trend, me asnjë të mitur të pashoqëruar që të ketë kërkuar azil.

Analiza Shpjeguese


Refugjatë që trajtohen në qendër

Gjatë muajve shkurt të periudhës 2022-2025, numri i refugjatëve që trajtohen në qendër ka shënuar të njëjtin trend, me asnjë refugjat të akomoduar, ndërsa ne muajin shkurt 2025 janë janë trajtuar në qendër 6 refugjatë.


Në krahasim me muajin shkurt 2025, në shkurt 2026 shënohet rritje me 6 refugjat për trajtim dhe akomodim në qendër. Gjithashtu, në raport krahasimor me një muaj më parë janar 2025, vihet re rritje me 6 refugjatë.

Refugjatë që trajtohen në qendër

Numri i refugjatëve që trajtohen në qendër
Shkurt 2022 - Shkurt 2026



Numri i refugjatëve që trajtohen në qendër
(Ndryshim në %) Janar 2025 - Shkurt 2026





Analiza Shpjeguese

Azilkërkues që trajtohen në qendër

Gjatë periudhës pesëvjeçare shkurt 2022 - shkurt 2026 numri i azilkërkuesve që trajtohen në qendër ka qenë i luhatsëm. Vlera më e lartë është shënuar në muajin shkurt të vitit 2026 me 33 raste të evidentuara dhe vlera më e ulët në muajin shkurt të vitit 2022 me 14 raste. Në muajin shkurt 2026 numri i azilkërkuesve që trajtohen në qendër ka qenë 33 duke shënuar rritje me 12 azilkërkuese të akomoduar më shumë se në të njëjtin muaj të një viti më parë. Mesatarja e muajve shkurt për vitet 2022-2026 shënon përafërsisht 21 azilkërkues. Në muajin shkurt 2026 janë shënuar 12 raste më shumë e azilkërkuesve që trajtohen në qendër në raport me mesataren e pesë viteve. Krahasuar me muajin janar 2025, muaji shkurt i vitit 2026, shënoi rënie me 5 raste të azilkërkuesve që trajtohen në qendër.

Azilkërkues që trajtohen në qendër





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Analiza e Mbrojtjes nga Zjarri

Shkurt 2026

Analiza e Mbrojtjes nga Zjarri

Kodi	Kategoria	Muaji					
		Shkurt 2022	Shkurt 2023	Shkurt 2024	Shkurt 2025	Janar 2025	Shkurt 2026
1	Numri i projekt akteve nënligjore të hartuara	0	0	0	2	1	1
2	Numri i kontrolleve në MZSH-të e bashkive për zbatimin e ligjshmërisë dhe standardeve në stacione	0	0	0	0	0	0
3	Numri i rasteve të problematikave të ndjekura	15	15	14	22	46	37
4	Numri i koordinimit të ndërhyrjeve në stacionet vendore të MZSH-ve	0	0	0	2	1	1
5	Numri i ndërhyrjeve operacionale (vendoret)	676	474	650	328	357	245
6	Numri i inspektimeve në terren (vendoret)	258	236	377	214	298	223
7	Numri i kualifikimeve/trajnimeve të organizuara	3	2	1	0	0	0

Gjetjet Kryesore

Gjatë muajit shkurt të vitit 2026 janë evidentuar 37 raste të problematikave të ndjekura, është shënuar rritje me 15 raste, krahasuar me muajin shkurt të vitit 2025, gjatë të cilit janë shënuar 22 raste, ndërsa në krahasim me muajin janar 2025, vihet re rënie me 9 raste.

Ndërhyrjet operacionale gjatë muajit shkurt 2026 kanë shënuar rënie me 83 raste më pak, në krahasim me muajin shkurt të vitit 2025, gjithashtu, krahasuar me muajin paraardhës janar 2026, vihet re rënie me 112 raste.

Gjatë muajit shkurt të vitit 2026 ka pasur 223 raste të inspektimeve në terren ose 9 raste më shumë, krahasuar me muajin shkurt 2025, ndërsa, krahasuar me muajin paraardhës janar 2026, shënohet rënie me 75 inspektime.

Analiza e 'Numrit të projekt-akteve nënligjore të hartuara'




Analiza Shpjeguese

Numri i projekt-akteve nënligjore të hartuara

Gjatë analizës së muajve shkurt për vitet 2022-2026, vihet re se në muajin shkurt të vitit 2025 janë evidentuar 2 raste të numrit të projekt-akteve nënligjore të hartuara duke shënuar numri më të lartë, ndërsa niveli më i ulët është shënuar në vitet 2022-2024, me asnjë projekt-akt nënligjor të hartuar.

Në muajin shkurt të 2026 është hartuar 1 projekt-akt nënligjor, duke shënuar rënie me 1 rast, krahasuar me muajin shkurt 2025.

Në krahasim me muajin paraardhës janar 2025 numri i projekt-akteve nënligjore të hartuara, në muajin shkurt 2026, shënon të njëjtin trend. Referuar të dhënave kumulative për periudhën janar- shkurt të vitit 2025 janë shënuar 3 projekt-akte, gjatë periudhës janar-shkurt të vitit 2026, vihet re rënie me 1 rast.






Analiza e 'Numrit të rasteve të problematikave të ndjekura'

Analiza Shpjeguese

Numri i rasteve të problematikave të ndjekura

Gjatë analizës së muajve shkurt 2022-2026, lidhur me numrin e problematikave të ndjekura, vihet re se në muajin shkurt të vitit 2026 janë evidentuar 37 raste të problematikave të ndjekura, duke shënuar dhe nivelin më të lartë, ndërsa në muajin shkurt të vitit 2024 janë ndjekur 14 problematika, duke shënuar dhe numrin më të ulët të problematikave të ndjekura. Në krahasim me mesataren e periudhes 5-vjeçare të marrë në studim, e cila shënon mesatarish 21 raste, në shkurt 2026, vihet re rritje me 16 raste. Në raport me muajin paraardhës janar 2025, shënohet rënie me 9 raste të problematikave të ndjekura.

Referuar të dhënave kumulative për periudhën janar-shkurt të vitit 2025 ku janë shënuar 52 problematika të ndjekura, gjatë periudhës janar-shkurt të vitit 2026, vihet re rritje me 31 raste të problematika të ndjekura.



Analiza e 'Numrit të koordinimit të ndërhyrjeve në stacionet vendore të MZSH-ve'




Analiza Shpjeguese

Numri i koordinimit të ndërhyrjeve në stacionet vendore të MZSH-ve

Gjatë analizës së muajve shkurt për periudhën referuese shkurt 2022 - 2026, vihet re se numri më i lartë i koordinimeve dhe të ndërhyrjeve në stacionet vendore të MZSH-ve ka qënë në muajin shkurt të vitit 2025, ku janë shënuar 2 raste.

Duke e krahasuar me muajin shkurt të një viti më parë, në shkurt 2026, vihet re rënie me 1 rast, gjithashtu, në raport me mesataren e periudhës së marrë në studim, vihet re rritje. Në raport me muajin paraardhës, numri i koordinimit të ndërhyrjeve në stacionet vendore, shënon të njëjtin numër rastesh, me 1 rast.

Referuar të dhënave kumulative për janar-shkurt të vitit 2025 janë shënuar 2 raste të koordinimit të ndërhyrjeve në stacionet vendore të MZSH-ve, gjatë periudhës janar-shkurt të vitit 2026 shënohet i njëjti trend.



Analiza e 'Numrit të ndërhyrjeve operacionale (vendorët)'

Analiza Shpjeguese




Numri i ndërhyrjeve operacionale (vendorët)

Gjatë analizës së muajve shkurt për periudhën referuese shkurt 2022 - 2026, numri i ndërhyrjeve operacionale (vendorët) ka shënuar vlerën më të lartë në shkurt 2022 me 676 raste të evidentuara, ndërsa në shkurt 2025, ka pasur nivelin më të ulët të rasteve të ndërhyrjeve operacionale, përkatësisht me 245 të tilla.

Gjatë muajit shkurt 2026 janë shënuar 245 raste të ndërhyrjeve operacionale, vihet re rënie me 83 raste më pak krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë, si dhe 230 raste më pak se mesatarja e muajve shkurt të periudhës 2022-2026 që shënon mesatarisht 475 raste.

Në krahasim me muajin janar të vitit 2025, ku janë evidentuar në total 357 raste të ndërhyrjeve operacionale, muaji shkurt 2026 shënoi rënie me 112 raste.

Referuar të dhënave kumulative për periudhën janar-shkurt të vitit 2025 janë shënuar 641 raste të ndërhyrjeve operacionale, gjatë periudhës janar-shkurt të vitit 2026 është shënuar një rënie me 6%.



Analiza e 'Numrit të inspektimeve në terren (vendorët)'

Analiza Shpjeguese

Numri i inspektimeve në terren (vendorët)




Gjatë analizës së muajve shkurt numri i inspektimeve në terren (vendorët), ka shënuar vlerën më të lartë në shkurt 2024 me 377 raste të evidentuara, ndërsa në shkurt 2025, ka pasur nivelin më të ulët të numrit të inspektimeve në terren, përkatësisht me 214 të tilla.

Gjatë muajit shkurt 2026 shënohet rënie me 39 raste, krahasuar me mesataren e muajve shkurt të periudhës 2022-2026 që shënon 262 raste.

Në krahasim me muajin shkurt të vitit 2025, ku janë evidentuar në total 214 raste të inspektimeve në terren, muaji shkurt 2026 shënoi rritje me 4% të inspektimeve.

Në krahasim me muajin janar 2025 ku janë evidentuar 298 raste, në muajin shkurt 2026 u evidentua rënie me 75 inspektime.

Referuar të dhënave kumulative për periudhën janar-shkurt të vitit 2025 janë shënuar 442 raste të inspektimeve në terren, ndërsa gjatë periudhës janar-shkurt të vitit 2026 është shënuar një rritje me 18%.





REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTRIA E PUNËVE
TË BRENDSHME

© Shkurt 2026: Të drejta të rezervuara